

ERVIN HATIBI

BIBLIOTECA

834.1

H 31.



6



poezi

ADVISORY
RATED R

TOO DRUNK TO ... (DEAD KENNEDY'S)

Tani disponoj edhe se ksin tënd
jam i lejuar ta prek
i lultur ta hukas

E ke të thjeshte ti
Thjesht rri shtrirë në krevatet e mijë
dhe urdhëron të pushojë muzika
të fiket drita
E qesh përtej mjekrës tënde me dhëmbë
si edhe përtej
Amfiteatreve të fytit
sytë e shtrirë, e bardhë, e bardhë...

Pastaj barku yt me faje tërheq
vrraga të trasha

ajri
Ti po e punon me shatë ajrin e dhomës sime
unë sillem nëpër dhomë si Lenini
bythët e mijë të zhveshëra në terr
janë dy o-të tek fjala alkool
E ty të këputet shpirti

qesh,
Me cicat e tua prej qeni, kur unë të them
se lipset të kesh edhe një pale të tjera si këto
Cica qeni që i kane varur sytë njera djathtas
tjetra majtas
si në flamur
(pushon e qeshura, ato pushojnë së duartrokuturi, cicat)
(bëhet heshtje)

ti kërkon pa u ngritur cigaret
 Që i mban në çantë
 ku ka edhe plot gjëra të panjohura grash
 Zhurma e çakmakut tremb barkun tim të vdekur
 i shkurtër ndriçimi, dihet, si një valë
 fshin shpejt figurën tënde nga rëra e syve të mij
 Atëherë unë shtrihem pranë teje

kjo cigarja si fëmije pleqërije, ose si ndonjë gjë
 tjeter më e saktë që i lidh dy vetë
 edhe po s'qenë aty të dy
 Fjalët e tua janë rrethuar nga një zë i padëgjuar
 ti më thua mes tingujve se s'duhet të të thërras më
 - Kur je i pirë... - shton
 Asnjë e dhënë tjeter pastaj
 për trupin tënd, a je shëndoshur më
 a i ke krejt vetullat
 Thonjtë e mij
 rriten
 janë ngulur në djersë
 në Viet-Namin tënd të rruar pa napalm
 Ti qesh megjithatë me tym
 Dhe unë ta di emrin
 E ti nuk do që unë të trishtohem
 Ndaj
 më pickon here-here
 në një nga bythet e mijë të ligura
 si mollëzat e poetit me tuberkuloz
 E asgjë
 s'më ndalon të qaj vetë
 mos ler të ulen sytë e mij.

PROBLEME NDRIÇIMI

Thithe cigaren, të bëhet dritë
 Tregomë se jeta është rrrotull
 Pastaj jetën mbushe me tym

Thithe cigaren, bëj dritë me frysë, pak
 Me këtë kraharorin tënd të zbutur
 Hapje-mbyllje syshtë ndriçimi
 Ne ulur përdhe
 Hijet lindin e largohen duke vjellë e duke u rrëzuar
 Ti përgjysëm e zhveshur si një rrënje
 Si një fëmijë i prapë, por me fat
 Ti kam fituar të gjitha kopsat në lojë
 Prek mishin tënd, gishtat na takohen në fytëtë shishes
 Këtu ka errësi, mishi yt fryhet si velë
 Thithe cigaren, ose le të presim
 Të kalojë edhe një makinë
 Me plumba drite ti vret veten
 Të gjitha kopsat t'i fitova
 Rrobat nuk pipëtijnë
 Fytyra jote nuk jeton
 Fytin tim nga brënda e ndriçon
 Barku yt i vogël bardhë e zi.

27 shkurt 1993.

WHOLE LOTTA ...

Nga një bllok në tjetrin më humb
një vjershë për ty Lotta

Ti ecën larg, e nuk druhesh të kthesht kokën
për të verifikuar
Supet e mijë: ne njihemi
Ne s'flasim: pa fjalë pa duar ti ma tregove
E para
Me shokët mes nesh e kërkua e s'gjetëm
Argjend i ngrohur me peshtymë
Aty ishte përdhe
Unazë gishti nënash që ia dëshiruam sho-shokut
E nuk e dallonim, një nga një kokëqethur larg shtëpisë
Në rrethina një burrë i huaj na përdhunonte
Pa frymë mbi njëri-tjetrin, larg nga shtëpia
Lotta, kështu kjo fëminia
Më vjen, me ikën në endrra
Mes dhjetra qelqesh, dialektesh ti Lotta
Me një triumf të hapur në faqe
Me një fustan më vjen, që më çudiste, e qaje
Kur me dhunë ta vishte mami
Gjunjët tanë puqeshin në quka
Në endrra është mehallë jone, filmat
Me shpata druri të menduara
Që na thyheshin: po bicikletën Lotta, bicikletën
Ku na mësoje bicikletën, c në fakt më mësovec dobësinë
(Do sqaruar mosha jote, më madhe se e jona)
Shtëpinë të kesh kundër, edhe rrugën
Fjalëve t'u druhesh, pa bërë dot pa fjalët e përbuzjen
E pastaj në darkë me bicikletën përtokë

Të të shkrythet gjoksi nga një vakësi pa emër
 Unë mbaja timonin, ti pedaleve u mëshoje
 Bark e kurriz ngjitur si një peshk i vetëm
 Fshehtas rrrotulloheshim nëpër rrugica
 nëpër dy boshte halash prej teli biciklete
 Jashtë asfaltit me vija të bardha, për ty flet mëhallat
 Lotta a të kujtohet
 Mos humbtë kurrë banja e vjetër e shkollës fillore
 Shtangia e mozaikëve të ujit përdhe
 Që pëshpërijnë në tavan
 Aromë e mirë e jashtëqitjeve të vjetra miturake
 E gjitha kjo gardhuar me gjëmime të forta gjoksi
 Se aty ishim ne
 Në kope, vëzhgonim si rriteshe pasditeve
 Si largoheshe nga ti, nga ne
 E nga bluza
 Por unë pérherë e kisha ditur se ti ishe ndryshe
 Të dy e kishim ditur bashkë se ti ishe ndryshe
 Ndaj rrija unë larg shokësh
 Të gjithë me tallën me hundë, shfytyruar për mirë
 Pantallonat e shkurtra që fërgëllonin poshtë nëpër gjunjë
 Këto
 Këto gjethë të reja në shirita filmi të vjetër
 Më flit. Kam dëshirë të jemi aty edhe një herë tjeter
 Aty ku fillove
 Lotta, ti çun i shëmtuar.

1993-1994.

MERZIA

Mérzia varfëron veç pjesë të trupit
 Të cilat fshihen nën bust
 Mérzia, piedestali që më larton
 Kësaj rruge pa tradita, pa barrikada

Të pjek mérzia, mérzia, mérzia
 Siç piqet një pikture antike, plasaritet verniku
 Pluhuri mbi pikturë i josh qepallat të ulen
 E tonet kuqërreme të burojnë nga mëlçia
 Prej pikturës e sajognë dhomën e vetëvrasjes, ku perdet u
 ulën
 është dhoma e mirë e miqve, me çelës
 I je qepur një karrigje të rëndë dhe nuk del kurrë
 Nga titulli i librit, brënda të cilit sigurisht që ti
 ekziston
 Nën emra të rremë e kujtese të njëllojtë
 Në një cep të bibliotekës do ta gjej të vjetër librin
 Mérzia, mérzia
 Merri gjymtyrët e mijë e hidhi në ndonjë lojë
 Ku veç mund të humbet
 Veç të mos e prek më trupin
 As të falem me to nuk dua
 Ose i ndërroj gjymtyrët me flokët e mij
 Ah, flokët e mij dy herë të prerë, aq të gjatë
 Mes tyre gjendesha mes një kopshti trendafilesh ujitur pa
 gjak
 Ku stolat këndonin me zë të harruar
 Shatërvani ...
 Aty midis flokësh i shpëtoja njerezisë
 Tek me sy të mbyllur ecja e s'më shihnin

Kërkoj flokët e mij që qenë të verdhë
 Po krejt ma thithnin të keqen dhe më linin mua
 Veç mërzira të mira
 Po tani që pa flokë kam mbetur, pa njerëz kam mbetur
 Mërzia
 është diçka e hidhur që nuk bën dot pa të më
 Si edhe pa e quajtur pikëllim apo me fjalë më të ndera
 është diçka që vërtet të kthen në bust
 Barkun me qime e kofshët t'i fsheh e t'i ruan
 Në një ujë të mbyturish
 Që t'i kesh për pleqeri
 Tani që zhduka edhe flokët e shenjtë
 një figurë e lojës me letra jam bëre
 Duke buzëqeshur me një lule gazi në dorë
 Me ca rroba të stolisura fort
 Bust, bust spathi, si fant
 Me dy kokë e katër duart me thika e gjethë të gjumit
 Tanimë mërzia si një gjarpër pëllumb
 Në një fole thurur prej flokësh të ngordhur
 Ngroh si vezë dy kokat e mijë
 Njëra është për vrasje, tjetra për vetëvrasje.

1994.

NETE SHKURTI

Të shtëna
 Nata shpohet e pikon
 U mbush qyteti me ujë prej macesh

Të shtëna, të shtëna

Rrëzohet gjumi përmbi nënët
Rrjedh nëpër udhë qumështi i gjirit
Valumi

Frika qytetare, meshë e mekur nën bankat e drunjta

Të shtëna, të shtëna
Zhurmojnë nëpër qepalla këpucët e rënda
Me këmbë të mitura ushtarësh brenda

26 shkurt 1991.

ATDHEU TURIST

Kamarda ishte këtu
Pantallonat e shkurtra
Aparatin fotografik nuk e shqiste dore
Vërtik kokën me flokë të bardhë linçuar
Flokë të bardhë, vargan turistësh me kërcinj konserve
Plakë prej shëndeti dhe qershori
Nën bluzat e bardha lisho e vesh trupin
Zhurmë zanoresh janë thithat gjinore
Tek hapin rrathë të shtrembër në ujin e ndenjur te bluzës
Çfarë drithërash Kamarda, plot
Jot shoqe parkon në pleqerinë poshtë bluzës
Nuk e lëshon aparatin, emri i markës
Me Y greke, që ndryshe kalamajtë e shqiptojnë
Të pisët lypin çamçakiza e qindarka
Të pisët, të shprishur gjaku
Plaka shtrëngon
Qemerin e kishës, që sapo doli
Ata shkruajnë se ishin aty

Të dy çift pleqsh
 kamarda kthehu në katund ...
 Aparati fotografik, aparati fotografik
 Kërcinjtë, falanga falangjesh, turistët e zbardhur
 Turistët, turistët, flokë të bardhë, të verdhë
 Kisha ku u martua Kastrioti
 Ishe aty Kamarda
 Shtrëngonit aparatin fotografik, këtu të vjedhin
 Dy cicat si një autobus i vetëm përmbi hartën gurore e
 pluhur
 Qumësht pluhur ish-qumështi italo-shqiptar

1994.

DY PERJETESI E GJYSEM

Sinjale të rreme të përjetësisë
 Alarme që hapin plagë-liqene
 Mu përmbi përrenjtë e mbijetesës

Nuset bojëkafe mbyllen me vërtik sa ma ndjejnë erën
 E kthehen në gonxhe pér të më mbështjellë
 Aty rreth vetes
 Tek qëndrojnë me kokën midis gjunjëve
 Po lotët brenda tyre janë të mijtë
 Lotët e çezmës së pazarit të peshkut

Se peshqit janë libra të mbytur
 Që mezi i kanë shpëtuar turrës së druve
 Më ka qëlluar ta gjej smeraldin e mekur
 Në fytin e peshkut

Po kurrë nuk e kapi rrjeta librin tim
 Që e shkruan yjet netëve
 Përmes koraleve ereve, që janë gurë të ndryshëm shahu
 Tek i ndan qimja e detit nga njëri tjetri
 Korale të zeza, re të bardha
 Ma zunë rob orën time
 Mbretëreshat e mijë m' i hëngri përjetësia ime
 E mbyllur në shtëpira publike me një përdorim
 Përjetësira të vogla, mbyllur në gishtat e mij
 Që tregojnë vend e kohës
 Gishtat e mij të tejpashëm me manikyrë gjaku
 Tek përkëdhelin flokët e kitarës që s'di ç'jam

Alarme, alarme të rreme përsosjeje (apo përjetësie!)
 Dora godet flokët e ngrirë të kitarës
 Por zhurma nuk është zëri i nënës
 E aspak mandarina e këputur e orgazmës së nuses
 Dizharmonike
 Apo hiç kjo zhurmë nuk ka lidhje me jehona nusesh
 Po vetëm
 Me mashkullsinë time si shërbimi ushtarak në front
 (Në çarçafin e bardhë, përpinqem t'i mbaj gjunjët lirshëm)
 Dhe kam vrarë më shumë se sa për t'u merituar Kain
 Se edhe veten kam

Gjithë trupi im, sytë, janë një shkollë fillore
 Që sapo e harron alfabetin, shpik një tjetër
 Puna është se nuk të kujtohet që mbase është po ai kod

Një grua, dy gra ma përgjojnë përjetësinë tek mbaron
 Sapo fillon tjetra.

1994.

PA LUKEN, PA MARKUN ...

Bëj faj, faje e pijë
 Pra përpinqem ta kuptoj Lukën si shok
 Puna është të mallëngjehesh
 Por edhe ta mallëngjesh Markun

Një çudi e vërtetë ishte dje në meshë, në gjirin e familjes
 I them troç nënës në vesh
 Një mendim timin për arkitekturën apo
 Diçka tjetër asgjesuese mbi artin mural
 Apo pasaktësitë në përkthimet e shenja
 Shihet qartë që jam pak ekspert
 E së këndejmi, nënë, mos m'u lut
 Nuk të vij më në kishë
 Por do të harroj shenja pikësimi nëpër poezi
 Dhe lidhëset zgjidhur i mbaj në këpucët jeshile
 Kur shkoj nëpër klube
 Arti, arti miq
 Dëgjoni ç'aroma metrike lëshon syri im.

1994.

KEPUCET E MIJA ALPINE

Këpucët e mijë kredhur me kujtime buzëkuqi
 Veteranë të tradhëtar autobusesh ku gjurmoja veten
 nëpër
 gjeografi
 Këpucët e mijë të përfolura (janë çarë)
 Pajtohen me erëmimin pritës të koridorit pa dritë

Rrinë e vdesin, do doja të më merrnin në pyetje
 Të më pyesnin për shembull
 Përse më zë makina dhe dashuria
 Teksa i iki vendit, qytetit
 E vetëm këpucët mora që atje, kur i zbrita
 Një shtrati të rrallë, të rrallë
 I lashë gratë të ma bëjnë me dorë mes dy shtyllash telefoni
 Ose midis dy plepash rrugorë pa shenja
 Ose koka e tyre plot flokë rrobash, kot qëndronka pezull
 Dhe unë gjithë dritaren e makinës e shpika
 Thjesht për t'u mallëngjyer vetë
 Fillikati ka shortin e zi të jetë jashtë
 E vërdallë reklamon një vetmi që lyp zili
 Por këpucët i ka të reja, të forta
 Kështu që nuk lënë njeri të mallëngjehet
 Por, po të vdisja, atëherë mbi varr do m'i vendosnin
 Me pluhur sipër buzëve, të mbushura me fshatra e çezma
 Stacion qeshë vetë
 Emrat e vajzave, targa makinasë të vjedhura
 1994.

**PER LEH VALESEN KJO BEJTE,
 SI EDHE PER INFERMIEREN
 E KETIJ PORTI POLAK.**

Gdansk!
 Bën arkë e peshkut plot
 lëshuar mbi beton prej dokerit
 Sevastopol-sy të mbyturish
 tek i rreh thellë shurra e diellit
 Durrrës

ngec barka në rrashë të rërës, a në leshterikë të shurdhuar
 Si mëlcitë Detin e Zi, e kam zënë e mbaj në duar

“Portet janë Sodomat e Marksizmit, rrethuar me ujë e
 katran”

Astrahan,

për shembull, tjetër emër porti

Dhe s’di si më shtynte pra ky Leh Valesa
 drejt Anarkisë e Rakisë

Tek shihja nëpër lajme të TV-së së Italisë

Pata qarë pér Leh Valesën

se e dashurova Grevën

edhe gjithë Polonitë

se urrej unë Qeveritetë

sepse hiç s’e dua Shtetin

dua Solidaritetin

këtë kopësht

zoologjik

pér njerëzit e njerëzimit

formën,

më fetare

të vetorganizimit

Dhe kam qenë i vogël shumë

Turma më mrekullonte

Katolikë e pijanikë-të gjithë shokët tubuar

Punëtorë nevrastenikë me mustaqe nëpër duar

Me fund gotën!

Dubrovnik!

Poshtë Bashkimi Sovjetik!

“Grevat bllokojnë Ekonominë, por çojnë para historinë”
 (!?)

(ERVIN HATIBI)

Leh Valesa pak nga pak u bë kryetar
 president polak i shtetit borgjezoproletar
 E krejt ma ka prishur
 qejfin...
 Por, të bëhet në dashtë Papë
 gotat plot me Poloni, do t'i rrëkellej prapë
 Le që kam edhe plot vese
 të tjera:
 Jam rritur në libra Rusë
 Atje bora është e zezë, çdo izbë është një pus
 Dhe muzikët plot inçeste të gjakosin me kamzhik...
 Të vettmët flamurë paqesh
 janë rrëza paragrafesh
 janë ije të bardha polakesh
 Që i pata adhuruar më fort se Leh Valesën
 E kurrë nuk e hoqa shpresën

Një polake, një polake !...!
 Për të fal krejt mëlçinë
 E të jetë rrumbullake
 Leshraverdhë nëpër shpinë
 Si kali të më hedhë
 nga shtrati në komodinë
 përdhe të ma lagë rakinë
 Gdansk! të më pëlcasë shpatull e kokë përdhe
 E t'i lutem krejt memec të më kthejë në sterë
 VARSHAVE ? DY HERE VARSHAVE
 është një tmerr katër oktavë
 këto llavë, këto llavë
 Prishjeje
 Që nisen përrua nga kofsha e nga fytë
 Përplasen përmbi mua mu në fund të barkut


si i bardhi Drin mbi të ziun Drin
 Drin!
 bërtas Drin!
 me djersë e valesë
 Zgjuar për turp nga gjumi në pavionin pesë
 Kati i tretë në Tiranë
 i spitalit infektiv, hepatit toksik
 Me mëlçinë time ekspansioniste
 Dhe embargon e konjakut
 Dhe bilirubinën që s'po më zbriste
 Shigjetuar kudo
 Si shën Sebastiani
 Me age
 Ndihmash polake

Dhe në korridore beh infermierja roje
 Domethënë ndez dritën ajo statujë prej pambuku
 Me gërshtetin e trashë si një krah pa jetë eunuku
 Që i rri në shpinë
 Me gjinjtë e lartë biondë përplot tetraciklinë
 Sipas meje: Rostok,
 (Dy studentë bënë qejf gjithë natën
 me një ish-detar ulok).

TOSHKEZ

X toshkëz o toshkëz
 me emër peshku
 toshkëz o toshkëz
 o fshat dyfeku
 që s'të kam parë fare
 veç kam parë vajzen lozonjare

54315



almën që s'është më fshatare
 toshkëz-toshkëz
 me kasht' e baltë
 toshkëz moj
 me hu e lopatë
 po të këndon ervini i ngratë
 ndryshe nuk e qasın gratë
 toshkëz o toshkëz
 përparimtare
 me çizme e shami basme
 shami basme nëpër gardhe
 gardhet janë nëpër ugare
 ugaret plot me fshatare
 të turpshme që punojnë
 punojnë që të rrojnë
 të rrojnë që të punojnë
 e jetë të gëzojnë
 toshkëz
 me gardhe e varre
 toshkëz
 s'ke male fare
 toshkëz
 plot me traktorë
 plot kombajna e zetorë
 brigadierë e revizorë
 shefa, dizenjatorë
 stallierë, viça e lopë
 kryetarë e agronomë
 kapistra, shalë, hamshorë
 pula, qena e milorë
 plot mullarë hamullorë
 kallamishte e piktorë
 plot flamurë tranzitorë

dhe mësues provizorë
 që nga shkodra gjer në vlorë
 toshkëz
 toshkëz me lëndina
 me lëndina e kodrina
 dele tulla edhe shina
 duhan rrugë e makina
 rendimente e vitrina
 plepa thana qepë vidha
 e kuti me aspirina
 që të mos na dhembë kaptina
 ka më pas xhamia e tjegulla
 por edhe vreshtë edhe pjergulla
 plot bute e fuçia
 rroftë vera! lart rakia!
 pellgje pellgje edhe çezma
 që në verë i zë lemza
 plaka plaka pleq shumë
 që i hyjnë gjithkujt në punë
 toshkëz me zhaba
 toshkëz pa kishën
 kishëzën e prishëm
 toshkëz me kanalin
 kanalin s'e ndalin
 pengesat që dalin
 për toshkëzën këngë
 thur tërë jetën

o toshkëz...
 o t... shkë...to...ëz
 t.

Në emër të popullit
Në sy të çunave të shkollës filllore
Që po kthenin nga mësimi
me xhepat me shkumës
që shkruanin "kurv" tinëz
tek muri i birrarisë
Fshatarët spiuën me triumf prej Edisoni
U turrën kush e kush
ta shihte më parë atë shtrat vogëlan
që e kishin ëndërruar gra e burra
mbuluar me një basmë të pastër
Do ta teproj
Po them se dikush liroi poçin e tmerrshëm hajdutçe
Mbase për të ndriçuar dhomën e miqve

Ndonjëherë kur trokëllojnë çelësat
vêrtet i brof zemra të mjerës, sidomos kur erret
i duket se kyç qepenat
të cilat bëjnë rimë me sutienat
Që në burg vêrtet luks janë
Në burgun e qethur të grave që plaken
brenda kalendarësh vetjakë
që përgjaken

1988-1994.

KURRE VIRGJER **(ironi e hollë për policinë)**

Kjo poezi, ky pathos
ka lidhje
me virgjerinë time

Po unë titullit
 nyjen ia hoqa mbiemrit
 e doli «virgjér»
 virgjin

Do ta marr këtë «e»
 të vogël e do ta vendos
 dukshëm në poezi
 Ide shapkash

Kur jam dhënë
 natyrshëm
 natyrshëm jam dhënë
 kurkush s'e zbuloi virgjerinë
 gjaku përherë i asaj tjetrës
 tjetër ish
 Jam dhënë natyrshëm
 se s'doja
 ende s'dija
 s'di as këtë

Do ta marr
 këtë «e»
 të vogël
 e do ta
 vendos
 dukshëm
 në poezi
 e
 dëgjoni
 unë po ju them
 Kurrë virgjér!
 Kurrë fashizëm!

edhe analfabetizëm!
(është me kushtetutë)

Ajo kurrë nuk e di
a jam
apo s'jam
e a jam
apo
s'jam
virgjér
Çfarë pyetje shapkash

Shapkat
mbahen rëndë për virgjér
të betohen të dyja
ashtu si nofulla gomari
secila
por të poshtme (nofulla)
aq sa prekin tokën

Plastike shapkat, shiten për të virgjëra
në supermarketate
Shiko edhe kontradiksioni
edhe shiten
edhe virgjér
e nuk dihet
është pranuar
se janë të pasqelura më parë nga njeriu
sepse janë të reja
se kur vjetërohen...
...askush nuk po çuditet
me murgeshat...
...por vjetërsia

Bëjnë përjashtim këtu
 shapkat e murgjive
 si edhe «shapkat»
 që në letërsinë shqipe
 ka edhe shpendë e kapele

1994.

Ç'BEJNE PIJANECET

e pra ç'bëjnë
 pijanecët
 gjatë kohës
 së lirë
 e cila nuk është
 edhe aq e lirë
 por në kohë robërie
 vëlla...
 e pra ç'bëjnë
 pijanecët
 në këtë
 kontradikcion
 brenda kohës së lirë
 e cila shtrenjtë
 është ndryrë
 brenda kohës së robëruar

pijanecët
 gjatë kohës
 së lirë
 shkruajnë poezi
 e gjeta

këta janë poetët
një, dy, tre
dy e nga dy
tre e nga tre
një, dy, tre
një e nga një
ata
plotësojnë
antologjinë
e poezisë
shqipe
(përjashtohen nga kjo poezi
ata që e bëjnë me qëllim)

1994.

HOV SIMBOLIKA, PER NJE FEMER TE LIRE

Kërpudha të vrara
në pyllin plot me refugjatë të mitur
Jarga e shtrigës së shëndoshë
vërtikës hapur midis trungjesh përpjetë
Një mëndafsh merimangash prej shiu
Në këtë rrjetë-kuvli të mbështjell
e ti
qan kot aty, kot
si një orë me zog
Herë-herë është më mirë të vdesësh...

1994.

GANDIZMI

Në çdo kodër, vreshti
 Portokaj euforikë kércejnë lart, prej puple
 (mijëra nëpër fusha)

Fushon djalli i porsaruar
 Një vajzë e mitur, krejt e nemitur
 i përgjon gjoksin prej zalli jeshil
 nën atë portik dielli me gjinj

Mbi çdo vreshtë, një kodër tjetër

Buzëqeshin shtambat e vona
 në krojet e helmuar

Një qen prej dheu, dy qen të shurrës
 nuk lehin nga frika, ruajnë vreshtin :
 vreshtat s'bëzajnë

Qentë dhe vreshtat ma hëngrën atdheun

1994.

BRENDA NE OBORR

Qeni im, diell dimri
 Ai rri me mua brenda avllisë së shtëpisë

Unë jam i porsazgjuar, qeni im është i vogël
 ma përtyp këpucën

Gëzohet si ajo fizarmornika e ngopur me alga
që lëviz në fund të liqenit :

Ja kështu, regëtin dhe jermi im pozitiv
brenda mimikës së avllisë, këtij ngërçi
që plot baltë më ruan prej makinave, e natës
që makinat kanë brenda

Gëzoj me qenin në vetmi
ca paqe ditësh të tjera

Bashkë urinojmë, kanotjera e lagur
balerinë e sëmurë e haremit tim

Me kopsa çliruar rend
me qenin tim

nëpër oborr me qenin tim që më ka gjysh
Kërkojmë nëpër oborr cepin me gurë me ngjyra
si personazhë të një qiliimi që s'shitet
e përfundimisht pérherë sytë tanë prej leshi të bardhë
i shkelin

këpucët me baltë të sallonit të jetimores

Dielli me degë i dimrit, me degë të kalbura

Kafka ime dhe e qenit janë skajet e dorezës
në të njëjtin telefon

Nuk do të rroj dot kurrë i plotë, vetëm me veten time
Do të vazhdojnë rendjet me qen në oborre
në pritje stinësh pa shqisa
në këto pritje që janë farsa vetëvrasjesh

Gjithë bota e di për mua
se ai bukën e fëmijëve vazhdon ta ndajë
me qentë e vegjël, me qentë e mëdhenj

këtu brenda
se unë bukë kam, por s'kam shpëtim.

1994.

NJE NATE PARA SE TE NISESHE

Tarraca nën yje, me oxhakë
(sot është mjegull, xhupin tim të bardhë mbi një karrige,
këtu në dhomën time, po njoh, me atë shenjë të djegure)

Unë, ti edhe vajza jote
Të tre ishim atë natë, zjarri ndezur mbi tarracë
Kërciste zjarri, zifti tkurrej
Zifti që shtrohet në tarraca
Tkurrej, e rripte me regëtimë si një lëkurë lope
flaka jonë në mollëzat vallëzuese

Pinim
Gacat e shkëndijat hidheshin në ajër si tapa shishesh
në një gosti që po e ëndërronim
plot njerëz, (symbyllur ne), plot njerëz të mirë
që deshëm t'i deshnim
Por s'i gjenim në botë, e symbyllur fikeshim
Termometra të vakët...

Si një mizë prej qelqi na zukaste
Në buzë fërneti
Pëlcisnin gacat, shkëndijat
e zjarrit
Pa e kuptuar unë
ju i knit e bënët pak dashuri tek arkat

E ktheheshit tē vetmuar, lëkundur
 tek unë ktheja i përlotur nga malli
 nga bota reale, reale
 ku i shumëfishuar në dhjetra sirena
 ndillja me dënesë tē dashurën e parë
 që s'më dëgjonte, veshët bllokuar me shtupa letrash
 nga tē vjershavet tē mijë

Ktheheshit e pinim, iknit, vinit
 Ishte hera e fundit, darka e fundit
 Dikur, (nata brenda kësaj fjale), ti ndjeve ftohtë shoku im
 Hodhe xhupin tim krahëve
 Ajo përthyer shikonte poshtë makinat
 E përthyer mbi një oxhak
 Pallatet na kishin rrëthuar me britma jete
 Tani po e kujtoja, nuk u dogj me cigare xhupi atë natë
 shkëndija, gaca e zjarrit kërceu mbi kurrizin tënd
 Tani që ike
 sy më sy vërehem me atë brimë tē zezë djegësire në xhupin
 tim
 A më sheh?
 (A tē mbahet mend koka e fëminisë varur
 mbi muzeumin me këmishën e shpuar nga plumbat, tē
 Qemalit)
 Tre ishim atë natë, në tarracë me oxhaqet
 I katërti u vra (ti ike brenda asaj vrime tē zezë tē xhupit
 tim)

1994.

QE RRJEDH

rrjedh shi mundimshëm në faqet e ajrit
 pezull rri, shtangur e gjithë natyra
 se çshëtë një vuajtje ky përqafim
 ky dyzim ujëejër
 dhe, lumturi është të bredhësh në shi
 i vetëm, i pambrojtur
 pikat të të puthin kokën
 me gojët e mëdha prej gjyshes kurva stërplaka
 çarja e dritave krejt ta zhurmon
 trupin tek vëren plot triumf se si vogëlsia
 kërrusja e njerëzve mbi shëmbelltyrat
 në pellgje
 hepohet në kthesa
 nxjerrefut qafën
 nga zhgualli prej çadre
 por ndjen njëren anije të të futë ujë
 llokoçitje; pesë detarë mbyten pa shpresë e zë
 pantallonat-vela puthiten pas direkëve...
 e pas kësaj katastrofe detare
 kur në shtrat i përhumbët zhvishesh
 prehesh lodhshëm, por i ngopur
 me flokët e derdhur nëpër gjymtyrët e thata
 ulesh; nuhat tërë kënaqësi
 gjendjen e çorapeve të lagëta
 P.S.
 c të duhet dhunë ta vësh poshtë
 shiun, këtë femër të pakënaqur
 që vonë, ndër një llum të përbashkët gjumi
 ndjen ta mekë ngashërimën e tejzgjatur.

27 qershor 15 maj 1991.

RE QE LEVIZIN

Fiket dielli i kalldrëmit; bëhet hije
 I gjithë oborri
 Sërisht buçet pas resh
 Dhe ngjallet mimika e hijeve të forta
 Mes rrezëllimës së artë që merr përdheu

Hija e hurmës së vjetër, e avllisë, e gjetherrushit
 Ma pikturomjnë krejt syrin tim të oborrit
 Me figurina të brishta

Por shuhet dielli, të verdhën e pi toka
 Dhe e nginjur në të mbyetet e zbehet
 Mbretëron një hije e ftohtë, mbulesë që ftoh

Dhe po mendoja, e bukur loja
 E qiellit me tokën
 Si një takim i shumëpritur
 I Vajzës me Djalin:

Kur qesh vajza, rrezëllin ai
 Kur ajo ngryset, vranet dhe djali

Më pas vjen muzgu e s'di ata ç'bëjnë
 Por ajri është i mbushur një tym të hershëm
 Buzëqeshjesh që në tokë u fikën.
 (Si cigarë të shkclura!!!)

20 prill 1991

KRONIKE NGA KETO DITE

I iki vetes me ditë të tëra
Me javë

Dy qënie që rrojnë si ua do qejfi
Po t'i njësosh del një jetë qeni

Ai këtu, unë tej çapitem
Kohë kam: këpucët ende mbajnë
Arna
Dhe dhëmbë të thyera të udhës së hiçit

Dhe shkoj në vete, i parruar
I ndyrë
Me plot zakone të reja rruge

Dhe vij në vete, heshtas e takoj
I marr bukë, vargje, raki

Fjalët e pakëmbyera-grenxa në zgjoin e kokës

Dhe udha e hiçit vazhdon të m'i hajë
Opingat e arnuara me lëkurën e faqes
Se unë vazhdoj kështu të jetoj
Me një lumturi të lodhur, të pabujë
Gjysmën time të jetës tonë prej qeni

10 mars 1991

PADURIM I PERSERITUR

Katër grushta balte të lagët
Llokoçiten në barkun e maces sime
Dhëmbët e tyre sa kokrrat e sheqerit
Ma brejnë përditë durimin

Dhe pres
Pres barkun e zbardhur lindjesh
Të m'i flasë kotësisë sime
Pranverore
Me mjaullima mi-minore...

Pres të dalin ditët të m'i mbushin
Me dritë, mëshirë, gërvishje të shumëpritura
Ditët e mijë të ngrira.

I paqetë bredh
Nën qiellin e barkut të maces sime
I përshkuar nga ndjenja të çmendura atësie.

8 mars 1991

DASHURI DHE SHISHE

Kur jam në dashuri
Nuk është ditënratë, orë nuk ka ekzistencë
I panjehsueshëm dhe emërueshëm
Momenti, intervali mes dy pjesëve të jetës

Edhe në këtë shartim 24 orë ka dita
 Por diç më shumë unë kam rrojtur
 E bota s'është përmbysur, përveçse
 Në sytë e mi

Kur jam nën dashuri
 Më tepër gjendem në dhomën time
 I hallakatur, i dërmuar
 Mbështjellë nga trupi si Saturni nga unazat
 Trupi, trupi, frymën ma mori!

Shishja e bojëshkrimit, shishja e rakisë
 Sy më sy vërehen trishtueshëm
 Rrëzuar bri meje

Kur jam nën dashuri
 E me që ra fjala tek shishet
 Jam si një hartë vulosur në një shishe
 Hedhur në oqeanin e vogëlsisë
 - Moj e ëndërruar që pranë i kalon
 Thyeje këtë dreq qelqi
 Dhe fill e vetme pushtomë
 Ishullin e thesarit!

18 shtator 1991

VUAJTJE

E mundimtë të bindësh veten
 Për qetësinë që duhet të rrosh
 Të vetëbindesh që një je

Nën helmetën e kafkës sime
Ndjej kokën e popullit (si të gjithë!)

Gatitem për luftë...

Hija e dhunës ma tredh heroin,
Profetin që rrita
Ndaj mbllaqës zemrën para fushëbetejës
Përkrenaret e çara të MUZEUMIT
M'i ftolin kamaret e shpirtit

Popull o plaga ime e braktisur
Kur vallë rastësish do të të jem hero?

17 mars 1991

VITI IM

Nuk e di ç'stinë është kur çelin
Fluturzat e kumbullës
Flakëza të bardha në lotin tim të zi
As kur shtrihet tejpashëm lakuriqësia në ajër
Dhe e ftohta e mishit të lyp lakuriqësi...
Nuk e di ç'stinë ndodh kur fusha ta shtron
Nën hap kashtën e ndezur gjinkalla-gjinkalla
Të gjitha në letër bukur përshkruar.

E unë s'i di, s'kam qenë, s'kam parë
Në ndenjen time të vetëvetmuar

Se s'kam ndjerë dashuri e çaste gezimi

Dhe miqtë të rrallë i kam patur
 (Fare pak mace e libra kisha
 Më plakeshin në duar...)

Ndaj vetëm rënien e gjetheve
 Atë stinë kam jetuar
 Rënien... gjethë të mëdha
 Me rininë time ca nga ca
 Fundosen ngadalë, me ekuilibër, të rënda
 Në kraharor mu këtu brenda
 E aty i handakos era
 E shqit me pahir nga këmbët kalimtare
 Këto relike mbretërish të vdekura
 Para të pavlera
 Që po ma blejnë kaq lirë jetën
 Veç këtë stinë-vit kam rrojtur
 Stinë ku zogjtë si gurë me ngjyra
 Mozaikun e shpirtit ma zhbënë e braktisën

Veç këtë stinë kam jetuar
 Thonë ka të tjera
 Në to jam i huaj
 O njerëz, a ka vallë të tillë
 Atje në planetin tuaj?!

11 nëntor 1989 - korrik 1991

RITUAL ME ZJARRE

- Erë flake ka floku yt Ervin...
 Shëndeti i tymit m'i lëroi dejet imët, nën det
 Zjarri është vetëm, mos e lër

Sa pa dalë nata
Flaka e do këngën tënde
Ta flashkë

Si flutura nate
Shtrirë pëllëmbët tonq pa duar, pa ne
Drejtuar zjarrit i humbin zejet
Duke iu epur përvëlimit bie pjalmi i gjyshërve
Një pluhur migrenash folklorike që quhet kallo
- Nuk dimë të bëjmë asgjë
Veç të shkojmë në parajsë
Tymi po ngrihet mes shalëve të qiellit (tymi i sajoi)
Eshtë një sy më vete ky zjarr, zjarri
I treti për çdonjërin nga ne
Do vdesim të djegur duke u ngrohur me Njohje
Pëlciti veç për ne kjo gotë prushi
Një vreshtë e tërë u rrënu si tempull në bulçitë e mijë
Hi në veshët e mij, që qaj
Historia është e njëjtë, me zjarrin që shuhet
Me mëngjesin në rrudhat e mijë
Ky lëng-raki i derdhur në prehër
Më vu ca syze të drunjta
E porsa tretet zjarri, syzet ndizen, digjen, bien
E bota më ngjesh në sy sakaq vrimat e saj.

1994

St. ENOLA GAY

Pasditja, si një limon blu prej hidrogjeni
 Tulatur në shpatullën time borgjeze
 Perandori e mosnjohjes
 Horoskop i shitur
 Pasditja e shpatulla ime me puçrra
 Të dyja
 Shpatulla nofull
 E një anti-lope
 Që pluskon shtratet e mijë
 Këmbëlidhur pas këmbëve të mijë
 Ky është syri im i munguar
 Kaq gjatë
 Pasditja, shpatulla ime
 Pasditja ime, shpatull në byrek të shpinës
 Qerpir mbi lotë të rrjedhur tinëz

1994.

PA TITULL DHE PA GJUME

Mesnata po më rraset në gjoks
 Si një frysëmarrje gojë më gojë me murgesha a sirena
 Nga xhami i thyer si minj yjet vërshojnë
 Mbi shtrat të lagështitur
 Gjymtyrët m'i pickojnë
 Një shishe e fshehtë
 Diku po më përgjon

Një shishe e plagosur
 Diku po më përgjon
 (Gjithnjë e më pranë)

1993.

DO TE SHPIKET NJË LENG OSE MAKINE

Do të shpiket një leng ose makinë
 Së afërmë, kush e di, zonjat do t'ia dalin
 Por edhe burrat
 Të dobësohen magjishëm, “flutura të një piye tragjike
 Që verbohen në gotën e rinisë brenda”
 Do të dobësohen, linjat, të sakta, do na përcmojnë
 Pikon si kompas djersa e arkitektit mjek mbi atë
 Trëndafil të zier
 Atë revolucion borgjez francez
 Që ndan vithet nga kurrizi-marrje fryme i gocës
 Që e kam dëshiruar 11 vjeçë
 Shkurt. Erozioni erotik i dhjamat do të botohet në faqe të
 para
 Testimet, reaksionet kundër
 E saktë fare, pa trauma makineria e dobësimit
 Do t'i eksorciojë në klinikë ai burri gjithë teprimet e
 darkave
 Barkun plot me kursime për një abonim, apo kurs joge
 Edhe zonja me psherëtimë do ta kullojë gjirin tullë
 E ca nga ca, do të shkojë prapë e penduar tek makina
 Mbase ta zmadhojë apo zvogëlojë edhe ca
 Me ç'rast do t'i rafshojë edhe pulpët që iu lodhën
 Bota do të mbushet me krijesa fine të Rodenit

Që bëjnë punë shpejt e seks si kthetra e harabelit
 Në telin me tension të lartë
 Pastaj thonë do të dalë edhe ajo makina tjetër
 Ai lëngu tjetër që do ta transportojë mbivlerën e
 përditshme
 dhjamore
 Nga laboratorët e dobësimit
 Groposur në shishka ngjyra-ngjyra
 Drejt e në botën e tretë do ta transportojë
 Në Somalitë me brinjë të dala shtatë qiej nën dhë
 E drejt e në lëkurën e zezë do ua injektojnë tamburëve
 të tharë nën palma
 Gjithë bythët e shalët e gushët proteinike
 Dhuratë nga pasditet suedeze të mërzitshme të Evropës
 E kështu do të vëllazérohen edhe racat në baraziti
 E njerëzit do të jenë tatuazhe të lumtur

1994.

E SHTUNA E MOTRES **(Incestit tim)**

Këtë të shtunë
 Dashuria hapi këmishën e saj prej nape
 Krisën kopsat përdhe
 Ne u derdhëm të kafshonim gjintë e saj prej smalti
 Ne dihatnim, nuk dihet a vërtet deshëm këtë
 Ca puthje me jehona alkooli
 Teksa gishtat na rrëzohen-panik në kënetën thithëse
 Të llistikut të brekëve të tua
 Sytë i kemi mbyllur (shihet herë pas here)
 Mbyllur e kushedi sa po vuaj

Më kënaq habia, ti munde të mos më neveritësh
 Bëjmë si të pirë që ta harrojmë
 U hapën kopsat varfër siç dritat ndizen
 U thërrasim taksive të dashurisë, si e ka sot emrin kjo?
 Vraje lodhjen
 Kjo është dashuria, kjo që po të jap për hir të dashurisë
 Ti tërheq barkun, fryma mbarohet
 Ti pengon dorën që shtyhet deri tek sharrat e qimeve
 Po, aty tek fushë-arrëzi i pabraktisur
 Aty ku zhurmojnë vatanet e bariut
 Do doja të isha ti
 Ta ndaloja, ta mbaja dorën e tjetrit fort, gishtat
 si ullinj në degë
 Pastaj të zgjidheshim, të m'i ndaje djersët si taste flauti
 Nga ashkla e zemrës brenda prehërit
 Të më ndizej uji i rrallë
 E shtunë. Ra këmbana e dashurisë
 Ra në kuptimin “u rrëzua”
 Përdhe që nga maja e këmbanares
 Ra edhe litari i brejtur me dhëmbë
 Si edhe këmbanari ra gjithashtu me kokë poshtë
 Me duart të buhavitura nga litari
 I kremitimeve të të tjerëve

1994.

PAPA...

Boritë e makinave janë si gaforret
 Ecin në të kundërt të akrepave të orës
 Në të kundërt të ecjes së rrotave
 I shtypin këmbët e kalimtarëve

Nuk tuten ato nga tregu i zi i semaforëve
 (Semaforët janë orë që jo me rërë po me epsh shoferësh
 E masin njerëzimin)

Boritë, ç'farë himnesh tē pavarura
 Që nē fëmini ushtritë e shoferëve fëmijë
 Nuk luanin tjetër veç me ulërima duke imituuar boritë
 E që atëherë veç prej tyre i urreja makinat megjithë bori
 Prej urrejtjes ndaj fëmijëve me rimorkjo

Boria

Papagall budist që ushqehet me benzinë
 I vëtmuar nē kafaz veç me shoferin profesionist
 Që përgjithësisht është një kafshë leshtore prej duhani
 Boritë e kanë mbjellë ferrin tashmë me veten e tyre
 E na presin tē lëmë qytetin
 E t'i korrim atje ku janë shurdhuese
 Duke kujtuar me sytë e dyllosur përjetë
 (Të parrezikuar nga asnjë aksident)
 Duke kujtuar këtë jetën tonë
 E cila fshihej përditë flagrante diku brenda torturës së
 borive

1993.

NJERIU

† Oaz i lëvizshëm qënka njeriu
 Ujë i menduar që i ndjek pas karvanet
 E do t'u japë t'i pijnë nga gjoksi

Oaz që avullohet është njeriu
 Ku pasqyrohet dielli
 Që nē trup na mbiu lullediell

Ngrohet me fryshten tonë

Dhe ç'gjë e bukur është dashuria
Bashkohen ujrat, këmbehen peshqit
Por ah, thesaret e fshehura s'lëvizkan
As kufomat e mbytura kaherë...

Jam edhe unë pra oazi, syri i dalë i etjes
Anije uji që në rërë noton

Mjerë që do të tretemi pa u lidhur det...

22 mars 1991.

ME TITULL

Ditën notojnë përkitas
Me ijet e mijë
Ca sardele konserve në valë të vakëta
Jashtëqitje anijesh të rënda
E dielli prishet në gjumë, pikon jargët në ijet e mijë

Ka anije burrash e grash
Tamam si edhe vë-cë
Anijet që ikin janë anije të grave
Përtej në brigjet përbri i zbresin
Nënët e fëmijëve tanë
I shkarkojnë nëpër netë e netët i qepin
Në sahatet diellorë të piacave plaka

Anijet që vijnë janë burrash

Të parfumuar e të lodhur
 Burrat e huaj na sjellin stofra e bulmet
 Plus makina elektrike
 Plus çdo gjë tjeter të re që bën fjalë
 Për këtë dymijëvjeçar që zhduket

Jemi kredhur kështu me portet për qafe
 Si me ca dëshmi penaliteti
 emi kredhur në këtë det bluxhins
 Pa përfillur asnjë simbolikë
 (Ku dreqin më çojnë velat e tatuazheve?)
 Nofullat plaka të ujtit m'i përtypin ijet
 Dhe interesohen
 Pyesin për Noen

Në ujë e në tokë njësoj jam, i zbathur
 Këpucët i harrova në derë të faltore që ma prishën
 Shumë e shumë kohë para se të lindte im atë
 (Ku është ishulli, ku zérat e dyshimtë e zjarri?)
 Rëra e ëmbël e vdekjes m'i përmbyt gishtat e lagur
 Dal në plazh
 Plazhi me bishta cigaresh, turistë
 Plazhi i shitur me bishta cigaresh,
 turistë
 Më tej është rruga, aty fshati, përtej qyteti
 Kjo është bota, ndanë rrugës është dhija
 dhe një tjeter grua e cjanit
 Nënë fëmijësh që e përcmojnë
 Nëna mjel dhinë, ndanë xhadesë
 Për të prodhuar kremin për fytyrën
 e llërët me vrima
 ku strehoen verat që ikën
 Harruar shtëpia e tyre ku unë

shpëtova
 duke u martuar me nënën e tyre
 Që më përçmojnë
 Aty rrojmë për inat të turistëve
 Që t'u shërbëjmë
 Jetojmë tërë vitin me atë që ata
 tërë vitin kursejnjë
 E vjedhim botën nga ky cep i vogël fare ne
 Aq sa mundim, kurrë sa ç'mundohemi

U shesim qumësht të freskët për banja
 si edhe shalqi
 Na blejnë edhe kapela të thurura me duar
 që rriten aty nëpër ligatat pas shtëpisë prej eterniti.

Hapen në rërë çadrat e plazhit, tej xhadesë
 se veturave, që po digjet-dridhet
 tej brezit me plepa, më ler të shikoj, lermë
 brekët e vogla si hapen mbyllen nëpër ecje grash
 tërhiqen, mbidhen ngushtë trekëndëshe si harta të Indisë
 që u nisëm ta pushtojmë qysh fëmijë
 Por përfunduan duke zbuluar Amerikën
 Natë për natë të neveritëshme në martesa shtrati
 tekxa larg dëgjohen dritat e hotelit
 Djersa e saj përmbi mua është benzinë
 (Benzinë e bojë poemash Ervin...)

Në darkë numëroj monedhat, nuk lexoj më
 Nuk pres rimat, fëmijët e vonuar pres
 që s'di të kujt janë
 Nga larg vjen afshi i dadove
 të hekurudhës së rrënuar
 Pres fëmijët dhe shoh televizion, ose brekët

e zeza me dantella të detit larg atje
 Mbi kofshë marramendëse të qiellit plot dhjamë
 të zbardhët engjëjsh

Fëmijët janë kornizat e dritës së hënës
 Ose të hotelit
 Janë një gardh i zbardhur fëmijët e mi, gardh
 që rrëthon gëzimin që mbaron
 të turistëve që vallëzojnë tek holli
 Fëmijët
 nuk duan të vijnë në këtë shtëpi
 Pastaj ata vijnë, unë fle
 Djersa e tyre është koka-kola
 koka-kola-koka-kola-koka-kola
 (Të pagëzoj në emër të atit, birit
 e shpirrit të shenjtë amerikan)
 Kalojnë yjet, teatër dritash në tavan
 prej makinave që në rrugë ikin
 Lotët e mi janë
 qumësht dhije
 E i pi një gjarpër thatim
 Unë mbasë desha të kem fëmijë
 Ose që fëmijë desha të më dilte nga shpirti
 një vjershë për nënën
 dhe rrija symbyllur, pa marrë frymë me lapsin në gisht
 Ishte sì një bindje e po asaj moshe
 se edhe gruaja e burri po ashtu e mbajnë
 frymën symbyllur, dhe barku mbushet
 i gruas, me një mjegull mishi
 Por, s'e pres më atë vjershë të lindet
 Jam kaq i poshtër dhe serioz
 I zhytur kokë e këmbë
 në jetë

Në këtë jetë bluxhins
 E vetmja gjë, të cilës ia arrita vetvetiu
 kur hapa sytë
 ishte se qeshe vjetëruar ca, siç rëra nxehet nën diell
 Dhe një turist më kishte vjedhur në tezgë
 kapelën e tij të kashtës

1994.

QYTETI PARAJSE

Qytetin parajsë, e projektuan të vegjël
 I ndreqëm përditë nga një diçka
 Aty i shtrimë ëndërrat e aty mbeti
 siç e menduan në fëmini

Qyteti parajsë na rritej me gjoksin
 Aty e ndjenim të frymëmerrete
 Aq sa na rritej, po aq ne gjykoleshim
 të padenjë për të

Ditët shtojnë rrudhat e rrudhat mëkatet
 Ato largësinë nga paraja jonë
 Ku mund të hynim e dot s'do të hyjmë
 përgjithmonë

Na joshi ferri (jeta) me pijet e rreme
 Me të vëtmet gjëra të vërteta në botë
 Me 'to ngrohëm trupin - shpirti mbet' i ftohtë

Dikur qyteti do të na i hapë portat e veta
 Do të na tronditit bari i gjelbër, vashat magji

Dhe do të rrënqethemi të llahtarisur

Atë çast qyteti parajsë do të na godasë me të vërteta
Dhe ne do të vuajmë bukurinë e tij
Agoni. Duardridhur drejt tij do na fiketjeta...

11-12 prill 1991.

NUK DI ME A PRES.

Pas ikjes tënde mbeta
Sypërlotur
Si një veturë me xhamë të thyer
Pas një atentati

Aty kam mbetur ku më le

Me biletën tënde të avionit
Dredh cigare
Për kancerin tim të vogël
Cigare që vezullojnë që përtej
Xhamave të shkrifet të veturës

Eshtë një far anemik ky. Të fton
Të ruhesh nga shkëmbinjtë ajrorë
Të mallit tim
Dita ditës ulen nga pak
Copëtojnë koka

20 janar 1992.

SI ÇAJ

Ka kohë, hënät e tua të urta janë
 Kuaj të zbatuar, të shtruar
 Hëna toke

Si pendime
 Përbrenda kraharorit më varen
 Gjinjtë e tu

Më kanë qetësuar ata djem të verbër
 Më vërejnë të ulur
 Në pragje portash të mbyllura
 Tek unë u fal pare të vogla mallëngjimi

Çfarë tmerri ata gjinj dhëmbërënë
 Krejt më kanë zvargur, tel kitareje
 Më rrokullisin në treva të turpshme

Rob t'u bëra, të lëshova
 Të lundrosh në liqenin ku veç nënën lejova
 Të mbytej
 Liqen i rrëthuar nga një mashkullsi e mprehtë
 Dhe e parrezikshme
 Prej bredhi

shkurt 1992.

KUSHTUAR

Më duket se të gjithë
 Kthejnë kokën kur jetoj
 E ndjej dhe skuqem
 E di
 Mbaj një erë të rëndë ullinjsh
 Dhe janë yje ata
 Vertikalish të regjistruar
 Si në një defter pagëzimesh të kishës
 Qepur nëpër mushkëri
 Me penjtë të cilët me dhëmbë i shkëputja
 Nga shalli i zi i gjyshes
 (Më shpesh aty gjeja thinjat e saj)
 Netësh të varfra i nxjerr si gjemba t nga thembra
 Këta ullinj gotikë, këta yje të ditës
 Me ta zbukuroj dhomën time
 Këtë bredh të krishtlindjeve të përditëshme
 Të gjallimit tim vetëm
 Më pëlqen edhe të sajoj vjersha.

shkurt 1992.

SOT KOHE

Pa ditë, pa natë
 Do jetë sot
 Hëna do të pijë kafe të gjelbera
 Nën shtratin tim
 Kurse dielli do ta bëjë
 Një tatuazh më gjilpërë

Duke kafshuar nga dhimbjet karrocën e tij prej sakati
 Mjaft më me këta
 Me këta prindër biblikë
 Sot do ta nGRE radion
 Dhe do të tretem në shalët e shtratit tim të tallur
 Teksa koka rrëshket në jastëkun shishe
 Pa ditë, pa natë sot le të jetë
 Unë dhe këpucët e mijë peshq vreshtash
 Kalojmë në ujëra orësh të paligjshme
 Por që i vetmi ligj na bëhen në verbëri
 Më parë ishin ngjyrat e hartës (ligji)
 Por sa skematikë ishim
 PËRTEJ penxheresh na shuhej e ndizejjeta
 Si llampë me alkool përditë
 Sa herë që hapnim e mbyllnim sytë
 Ora është gota më e mirë
 Një orë tavoline, muri e mbushur
 Plot me numra
 Jam porsi një kloçkë që sheh rreth vetes dymbëdhjetë
 fytyra
 T'i sillen rrötull, e mezi t'i gënjesht në luadhe
 Por pa akrepa, siç e thashë
 Me ta dielli bën tatuazhe me nudo në llërë
 Vetëm kohë pa xhingla
 Më sheh syri në shtrat
 Urtë e butë e plot sahati
 Plot me shkronja e gjethë

gusht 1992.

I MIRE I DJALLIT

Biri i mirë i djallit
 Më fle vdekja e përjetëshme
 Në qepalla, në kotelet e sqetullave
 Bir i mirë orëve të gjata të jetës
 Veç pak çaste gjumi të ndershëm rroj
 E këto në këmbë
 Të poshtër e kam gjumin e natës
 E krejt më e poshtër dita
 I mirë
 Eci nëpër ca flakë të ftohta
 Sytë ma pasqyrojnë dobët në trup
 Ferrin
 Sytë kapakë floriri të varrit
 Festë eternale e lodhjes
 Drita, vegime më lagin kokën
 Po vij, po vij
 Biri i mirë i djallit
 Me fat më të mirë
 Se i keqi, bir i Zotit

1992.

ME QUAJNE MIKADO

Mikado? Mikado?
 Një pasdite e re i thyen kitarat
 Në veranda me diell
 Fle djersa ime e puthitur midis pasditesh
 E xhakonët më thonë të fle edhe unë

I mbytur në gëzim e në djersë
T'i gjej lulet aty ku mbetën, por shalët ama
T'i kem të ndryra
Ndërkaq që vrapoj, brenda në rraso
Mikado
Kopoj qindra pasazhe, të themi dyqind në ditë
Treqind
Nga çdo kod penal e anal
Dridhem në qelinë time të murgjve
Që të mësoj të ëndërroj me njerëz
Vdiqa nga dhimbja e barkut në verandë
E dielli rrëshqet si vezë e thyer breshke
Nëpër trup më sillet e dot s'e zë
Kështu që e mohoj
Veranda e shton dhimbjen e barkut në çdo pllakë
dyshemeje
Ku rrëshket dielli pa frysme e dot s'e zë
Dhe e mohoj dhe zë me derë rrason katolike japoneze
Ndërkaq që vrapoj
Dhe bie me turinj, me derë të mbyllur, me njerëz
Duke ndarë në jashtë dhe brenda
Diçka që është ndarë në lart dhe poshtë

1993.

DANISHT

Danisht e shkroi ajo librin
E patave të egra
U ngjiti dhe emra
Personale
Sapo hapet fleta e parë

Si kandrrat emrat patat kollofitin
 Sapo hapet fleta e dytë
 Një aromë djerse gjysheje ndjej
 Në sjetullen mes dy fleteve të librit
 Eshtë vendi ku gjyshet na përgatitnin
 Të lindnim
 Më kujtohet kur i pyetnim nga dalim
 Prej nga sajohet lindja jonë në bote
 Ato thoshin nga sjetulla
 Shkujdeshëm sjetullën na dëftenin
 Një të vërtetë që të turphshme e bënin qimet
 Prej aty lindi dhe letersia për fëmijë
 Bile dhe femijë lindi sjetulla
 Teksti flet qartë
 E shkroi një grua
 Danisht
 Ilustrimet me akuarel joshin njëra-tjetren
 E kështu fletët lëvizin, më zhvendosin
 Pëllëmbë për pëllëmbë
 drejt fëminisë
 Fëmijë-agoni, i grisja librat për fëmijë
 Fëmijë i lig që vetëm dyshoja e gënjeja
 Kështu që qeshë i pari që zhvesha një vajze në mehallë
 Miturake si une e shfletova me një gisht të laget
 Dhe keshtu i fundit te prova një dekade me vonese
 Duke shfletuar vetem libra si ato mbathje të pastra kukulle
 U rrita në libra, qeshe i fundit që zhvesha një vajze
 Por të pakten shpetova
 Nga dhelpra
 Dhe dliresia e pules
 Si edhe nga fshatari i muncur që mundi mbretin
 I shqepi edhe të bijen
 Dhe ja kam arritur të shkruaj për mrekulli

një vjershe që i vogel
 për syte e pafaj të ujkut
 Dhe frymen e tij të athet
 që hukat zemren time-kembane
 Foshnje rritur në një pyll të shpyllezuar
 I zgjodha që pa mesuar të lexoj
 Librat
 Me një shqise të inatosur që i ndan sakte
 Kerpuhat e helmeta nga të ngrenshmet
 S'pati kelysh kurve të me mbylle
 Në azilet me ilustrime të femijeve
 Libra të shiturish ku fillon dhuna
 Ashtu si e pakuptuar
 nje inkuizicion i madh, një zjarr duhet
 Ta djege injorancen e librave për femije
 që jane libra si tagjia në drithera
 Gjenerata të frikeshme rritur nga gjyshe që vdesin
 Dhe libra me makiavelizma junioresh
 Poema për fashizmin kristian dhe alkimine
 Libra që në fakt duhet
 Plot art e lajle të na i servirnin
 Por krejt të thinjur
 Të deshironim vete të vetehumbnim kontrollin
 (Le të prallisnin kuajt c'te donin, le të thyheshin gardhet
 Nga pornografia infantile)
 Të na provokonin sa të donin
 për të provuar besimin e forte
 se nuk eshte krim vetem ta shkruash librin
 se nuk eshte krim vetem ta shkruash keq
 se nuk eshte krim vetem ta shkruash danisht
 E patave të egra danisht t'u ngjitesh emra
 Krim eshte se ti je nene, duhet të jesh nene
 O nene, libri eshte perdhunimi i pare që pesova

Sapo mesova të lexoj
 une nuk desha të perfundoj keshtu
 Por libri keshtu perfundoj
 Fjale...
 Pra krimi yt eshte se lehte-lehte
 Projektove
 një dhune të destinuar për femije
 Me pata folese daneze
 E bere sic thashe lehte-lehte
 Pengesa e vetme, arti i gatimit dhe morali
 që nuk e di a i ushtrove në javet intriguese
 Kur shkruaje cudine ritmike
 që s'ndalej as nga ato vete
 Oh... zonjushe me fal, zonje skandinave e pa emer
 Me fal për gjithe kete ligesi
 Ate kodosh liber në fakt as që ta kam lexuar
 Por ky terbim me mban gjalle
 (Jam krenar që kam qene i kuq flake)
 E ta dish, ka kohe, vetem sa lodhem për pak qetesë
 Pak vetepermrbajtje
 E mbase eshte e vertete që ne i duam femijet njesoj
 Dhe qetesine
 Dhe une mbase paskam bere krim
 një fjale e fundit :
 A ke qene krejt e qete për ato patat
 Kur i shkrove
 Apo je treguar kaq makaber sa na ke lene të zgjedhim?

1994.

SIDOMOS NE GUSHT

Në plazh: deti!
Meqe nuk e beme dot revolucionin
Notojme gjithe inat, gjithnje e me larg e thelle
Sa me larg bregut, aq me afer qillit
Pulebardhat e paguara të kartolinave po aq larg nesh
Mbeten
Nga shpinat tonë
Ose rralle të papaguara mbeten
Sidomos tani në gusht
Të gjithe jemi një popull i zeshket
Kolonesh indigjene
Gjysem nudo sajuar me ca recka prej ngjyrash kuptimplotë
Vrapojme në rere e blejme xhingla e ore
Bejme flirte e marrezi të embla
Pastaj i falemi perkulur diellit nëpër hije
Dhe pagezohemi tek uji me fekale i detit
(Ato të grave gjithe qime si ca gaforre të erreta, prifter
mijerakembesh, na mbajne mberthyer në kete pagani)
Perdite vijne mbushur trenat dhe rrotat me të internuar
të rinj
jane ata që deshen të bejne
Revolucionin
Apo ndonje ngerdheshje në publik
Të dhunuar nga policia rrugore gjithe vitin
Rruga e tyre mbaron në det
Ketu i sjellin për qetesim, për ndreqjc
(një qetesim plot nxehtesi, plot shale që bertasin,
motoskafë
prej shtufi, akullore si citate)

Rera vetem meket e të mek: na kujton
 Debimin
 Nga shtepite tonë
 Ose token e premtuar
 Por në e zgjodhem vete plazhin
 Cifute të zhveshur në breke
 nen një diell krematorik
 që kapitali e zgjidhi dhe nga zinxhiret e ozonit
 Dhunojme njeri tjetërin reciprokisht për hic gje
 Sapo heqim maskat prej rrobash, që sic thashe
 Poshte ndryjne njerezime të tjera
 Sapo vjen vera
 Rriten temperaturat
 Demokracia e qeveris qytetin e braktisur
 Me grushtshtetet e lodhura të turizmit

1994.

St. Exupery

Kaq dite në toke që eci
 Mbi kurriz vetja m'u lodh
 E kembet m'u enjten, syte m'u fitohen
 Kaq dite e trembem të verej
 Cfjale paskam mesuar
 Cfare lajmësh
 Ndaj sot serisht e serisht vendosa
 përfare ta le kete jete të gjore
 Kembesore
 Habitëm si mund
 Të durohet gjer në fund
 Kjojeta ime e gjore

I gatita pra flatrat, të pluhurtat, shpupluar
 Të rinis prape ate jeten tjeter
 Prej verteti
 Ku netet jane dite perpjekjesh nen yje, e prej kesaj
 syte lumturohen të jene të enjtur
 Kam për ta shpikur aeroplanin e vertete!

18 shkurt 1991.

NENA JOTE

Haj buke
 Se eshte darke, si bore e thate bie në tryze
 Fle e flas me vete
 Tek kuadratet me therrime në mbulese
 Me therrimet
Njerez të vegjel që pijne duhane pa tym
 Zhurma e cesmes rrrezohet nëpër pllaka, me rrethon
Me nena koncentrike që i ruhen ndricimit, e shtohen,
 shtohen...
 Une i kam varur veshet në ajer për vathesh
 syte bien në fund të rasteve të qepallave
 Si llumi i kafese
 E engjelli m'i zhvidhos duke qare sandalet e mijë prej
 rakije
 Kapitull XXII, kapitull XXIII
 Haj buke
 Capa buke
 Buke me djathe bardhe e zi
 “Po kaperdija një murgeshe”
 Buke e djathe e mister
 Pas cdo hapi buke, bute-bute golfe sintetike, keneta

Nena harrohet me lopet e diellit, nena ingranazhe-
ingranazhe

Pa gjinj

Ma fut në bythe lugen plot Cernobil, pas cdo kafshate të
shkujdesur

Une nuk ankohem me, kjo eshte buke e falur
Drita fiket, nata shkelqen si një mobilje salloni
transilvanas

Formulat e drojtura të kimise se djathit

Bien me heshtje, vendosin pertej carcafit thonjte të m'i
ngrejne si "mjegull varri"

1994.

ZERA NE KRAHAROR



Zerat e dashurise serisht me turbulluan
Filize të drojtur në zgavren e ketij lisi të thare
që jam une

Cgezim i tronditshem të ndjesh

Se

Nuk ke vdekur

Zhurmat e dashurise, oh, me drodhen

Tinguj

Të një monedhe të arte që shket

Në gurmazin e kutise telefonike

Të gjoksit publik

Vetes po i telefonoj të kthejë nga shkretetira

13 shkurt 1991.

JAM LODHUR NGA BUKURIA JOTE

Jam lodhur nga bukuria jote
që ti aq thjesht ma fal
Aq lire
E pa me njohur

I pafuqi, i pafuqi eci
Eshtrat si hardhite në pranvere
Qane ose m'u drodhen

Veshtrimet drejt ajrit tend
Plage me rreshtohen
Dhe qepallat s'me sherbejne me dot:
Ti rrон ketu brenda
...u cmenda.

24 mars 1990.

MENGJESE

Të dua fort, mos ik o dreq

Oh, naten c'po e trazojne
Gishtat e ftohte të gjelave...

Kokat mengjesit jane salsa kinemaje
Drita që rritet e zbeh gjer në shuarje
Pelhuren ku gjalloi enderra

11 maj 1991

BOCET

Bocet balte e mbruaj veten

Cdo nate

Dhe e prish cdo mengjes

Me kalim të kohes në vend ta persos
Po e bjerr kete zeje të dhimbshme

(E ngjiz me gjithfare figuren time
Varet nga vendi ku me zu terri
Pra, me se tepermi me llum kenete
Mocal u be gjithe dynjaja
Pikellim kallamesh e zvarranikesh)

(Por jo se nuk has në lluce të fisme
Qelloj të mrekullohem me ate c'ka krijohem
Tek yjet ma lepjne vetekrijimin)

Mbruhem cdo nate
Prishem cdo mengjes
Pa shkak
Paformes time i le gjurme
Hapi tek tuk e kalimtar

Dhe eshte një bocet pa fund
Shtatore ketu kurre s'do niset
Por
E vazhdoj lojen time të persosjes
E me se shpeshti e besoj
E dita-dites po e bjerr zanatin

Eshte thene të vdes pa krijuar.

9 maj 1991.



BEFAS

Sot befas nuk u zgjova femije
Si lekura e gjarperit m'u zhvoshk ndër gjymtyre
Feminija
E krejt lakuriq mbeta rrëth një muri
Prej sysh mizore

Brryli i udhes sa shpejt levizi
Femijen për duarsh ma rrezoi pahiri

M'u thye, m'u thye nga pak perdite
Shembelltyra prej balte e feminise

M'u dogj në balle kokrra e lotit
E krejt m'u zbraz vetja prej gjoksit

Po me i rende ndihem
Sa të rendoka se brendeshmi mungesa
E fytyres se vjeter
Prej femije

6-7 qershori 1991.

DASHNIA

...në fund të fundit të dashurosh
Do të thote ta dashurosh dicka sic eshte
Kjo flake e marre e tall
Edhe shqisen me të forte
Duke lene zemren të ngujohet
Në kullen e shikimit të pare

Eshte koha, masa e cdo barriere
që të kapercen edhe të le
Në një braktisje të enderruar
Vetmi dyshe të perveluar
që të persos e të ben edhe me
Vatres se turbullt r'i avitesh
Ku e dogje boten gjithe
Ku edhe materia me ideale
Behet hi para se syrin të preke

Dikur pendohesh për gjithe c'ke pire
Atehere, Diten e Goditjes se Madhe.

e diele, qershori 1991.

TIRANA NENUJORE (Poradeci)

Zbret nata si batice në mehallat tonë
Me uje të zi i permbyt shtepite
E syte tane të lodhur
Portet e fundme të drites

E mu atehere si pare e drunjte
Hena kercen nga thellesite
E del e pluskon mbi siperfaqe

(Ushtareve u mbaroi liridalja
E i kycen në kazerma
Kurse të vdekurit e gjore tani
Thone i nxjerrin nga varreza)

E ne të fashuar në shtepira
Tymosim merzine tone të gjate
Krejt nikotina na i nxiu shpirterat

Vjen ora, burra e dinosaure mesyjne
Shtratin bardhosh ku i pret një grua
Me goje dhe duar

Mua edhe sonte një nate dyfishe
Me perqatiti perendia
Me gishta që mbyten në ujera letre
Pa i gjetur dot brigjet e mijë

shtatorit 1991.

POEZIA E HUMBJES

Ti asnjehere s'e kuption cfare humb
 Lodron si një mace në hapsiren
 E gjelber të syve të tu

Dhe une i fyer, i poshtuar
 Të pergoj pas hijes time

Behet vone, sa vone nga ndarja
 Une mbi prush thyej shkarpa
 Si idiot i fryj hirit
 Ndizu o i shurruari zjarr
 Dhe hedh aty lule, shami, vjersha
 Rrobot e cdo gje që kam
 E ngel një lakuriq i varfer, zhveshur
 që zjarri dot me s'e ngroh

Ti asnjehere s'e kuption cfare humb
 Lodron si një gjethë në lulishtet pa ane
 Të syve të tu

Por une dua të të dua
 Me cdo kusht

9 shtator 1991.

SARAJEVALIUM (pour home)

(Instrumentale)

nëntor 1994.

FEMINIA E PAJETUAR

Në heshtjen e pasditeve të mijë
Zhurmon feminia
E pajetuar

Nuk jane kujtime, por enderra
(A do ta gjej valle një pyll rrëze kerpunderash
Vezen e murrme të ujkut?)

Enderrimet e mijë pasdite
S'jane erotike

Femije i vdekur kam qene
Serioziteti im idiot e praronte varferine
E kur e vishja, visheshin verber
syte e mijë të botes

Femije i vdekur
Orendi e vetme mbi dollapin e krimbur
Të kuzhines

Nuk i laj duart, vonohem rrugëve
Ze shoke të bukur e të cmendur

Bredh me llastik nder xhamat e shkolles
 Si tulla librat i shemb
 Ata libra sharlatane që ma murosen femijen

Pasditeve të mijë
 Trokon feminia
 Ime e ardheshme
 Pa zhgarravina

27 tetor 1991.

AUTO

Flene në xhepa
 Letrat e padërguara
 I ndjej nën lëkure rreshtat të pëshpërijnë
 Zarfat tek dridhen
 Filateli që të dashurit nuk do të mundin
 Të ma shqisin nga mishi

Janë letra që mbasë edhe i shkrova
 Por vetes ia dërgova
 Në adresë të largëta
 Thuaj se veten dua të sqa roj
 Me arsyet e të tjera
 Për pamundësime e mijë

Më flenë nën lëkure
 Letra
 Një tufë e tërë
 Letra që mbasë edhe do të nisen
 Në fakt u nisën, por për tek unë

Që si një kuti postare e vjedhur
 Grumbulloj për vete një farë ngrohtësie, fjalë të mira
 Që vetë i shkrova për të tjerë aq mirë
 Sa nuk mundet askush të më shkruajë

tetor 1991.

PERMBI REVOLUCIONIN

Më mbaruan cigaret në stacion të autobuzit
 Duke pritur revolucionin tjetër
 Këtu kam mbetur
 Gozhdë e përzhitur, e shtrembëruar
 Nëpër shkrumbin e kishës së djegur

Si nëpër pistoleta me mulli
 Të gjithë janë futur kokë më kokë
 Nëpër shtëpi

Gjithë revolucionet të parafundit janë
 E gjithnjëjeta ime e fundme, e fundit
 Lirë m'i bleve lotët, m'i bletë
 Krejt trupi më dhimbte nga dashuria
 Për popullin e barrikadën.
 Dua të vdes e ta harroj
 Të vjell. Dua të vdes kot
 Ose hiç të mos vdes nëse duhet
 Të vdes me qëllim
 Do marr një lypes të mitur mulat
 Ta ngroh e ta rris ndyrë
 Ju ftoj të gjithëve në strofkën time
 Të më pështyni në fytyrë

Veç mos të më provokojë njeri me plagët e veta

Por rroftë, rroftë flamuri i ri
 Edhe çdo dashuri e vjetër
 Në ardhëtë prapë dita, në rrugët prapë do jem
 Me gurët do godas patjetër
 Ata që janë grumbull
 Dhe ata që rrinë vetëm

1991

VULLNETARI

Sa herë kthehem nga kufinjtë
 I gjej të gjitha martuar
 Askush nuk qan për këtë luftëtar
 Që me shokëtë pakët pushton toka të reja
 Zmadhon atdheun
 Asnjë letër e parfumuar për këtë vullnetar

Po në një ose një tjetër mënyrë
 Do t'i zbusim fiset e vjetra, tokat djerrë me komitë
 Perandoria do të përfundojë dikur
 Megjithë kokat e grave, që tek luftojmë
 Si skllevër i tërheqim, varur gjyle në këmbë
 E s'janë tonat
 Në një apo tjetër mënyrë
 Perandorinë, Atdhenë
 Njerëzia
 Kur ta kenë
 Të përfunduar
 E t'u venë

Ushtarë burrat nëpër kufinjtë
 Që në vete aq të largët i sajuam
 Krejt të sendisur e kokëruar kur t'u venë
 Në mbrojtje trojesh që hiç s'i kërkuan
 Atëherë qeveria do të na ketë dekoruar
 Duke fshehur plagët e shëmtuara me duar
 Në sheshe do hidhemi me fishekzjarret
 Ndërsa nisen trenat me ushtarë
 Do hidhemi e do kércejmë
 (Duke pasur kujdes mos shkelim guackat
 Ku ato ndryjnë gjithë veten e tyre
 Të lagësht e përulur
 Me një bindje eprore që të deh)

E aty mes dantellave intime, letrave të mallit
 Fotografive të të parëve, e kutive të duhanit
 Kur ushtarë burrat t'u venë në provincat e largëta
 postare
 Do përpiken të na joshin që t'u bëjmë shoqëri
 Por ne do t'u shmagjemi
 Atëherë vejushat do të na bëjnë propagandë atdhetare
 Për të na mbushur mendjen të martohemi, të bëjmë
 fëmijë
 Të fyera do të flasin ashiqare
 Por ne të plakur do t'u tregojmë përfushatat, vetminë
 Për vrasjen e robërve, babëzinë
 E dhjetra budallallëqe të tjera të vjetra nga lufta
 Do t'u falim dekoratat e asgjë më
 E do ikim të pijmë në klubin e veteranëve
 Duke menduar për një kryengritje të errët
 Për të përbysur perandorinë

ETNIKE

Fyelli

Nuk mundi te jetë prej mishi e gjaku
Noton në perrenj, në nje perrua rridhte
Zbriste, dredhonte, zvargej në gura

Renqetehj - myshqet

Tretej - peshqit

Nuse te humbura e te mbytura

Si gishtat e ndiqnin në rrjedhe

Vec nen uje i bije dot

Fyellit

Mbeshtjelle nga floket e mij prej uji

Barinjte jane mjeshtra

Bagetite - zota

E une nje qytetar i dores se dyte

1992

**PLAN PER VETEVRSJE TE
PJESESHME**

E pandryshueshme skema e diteve

Qe bartin te henen, te marten, sabatin

Keto në fakt jane

Ca rruaza në trupin tim prej krimbi

Kalojne te premtet, pa meshire te merkurat

E njera tjetres hic s'i tolerojne

Keto karroca ambulantesh qe shesin te njejtin frut

Tek dielli plehron varrin tim te hapur
 E ngroh gotat e mijja te veshtira
 E keshtu java mbushet me muzike filmash
 E me krimba në fruta te ndaluar

T'i vdesesh te premtet, t'i shkelesh te enjtet
 T'ia thyesh nga dy dhembje gojes qe ma kafshon jeten
 perdite
 E ta mbushesh qe tanj varrin me ato
 Qe jane sot e do te vijne
 (P.sh., vetem me te henat e te merkurat)

28 maj 1993.

DAL NGA PORTA

Kalimtare carcafet
 Qe qendrojne me gjate se per te ndezur nje cigare

Iki e vij vone ngajeta ime
 Ca te brendeshme gjeli kullojne djerse te varura
 Fikur tek llampa e dhomes
 Pastaj drita ndizet, edhe dritaret:
 Kjo eshte nena, domethene, qe shkon në pune
 Me te vluarin e saj si nje cajnik i madh prej leshi
 (Duhen heshturazi, sikur dikujt t'i vene brire)
 Nuk ndihem, ata dalin
 Ha pjaten e eger te mengjesit ku deshton e skuqur
 Pula, kjo shpeseri militare
 (Prappe me tavoline kater kembet e saj)
 Nuk shkoj në shkollë
 Hidhem me vrap te gjej kembet e tua te shtrembera

Te me hedhin si nje hobe në nje gjume qe s'te rrit
 S'te qeteson te keqen nena, s'te nevojitet
 Por s'te ndahet ama fare
 Gjithe naten në gjume

1993.

DRITARJA

Bie shi: vetem keshtu u vendos per sot
 Dhe per dje
 Shi
 Në rruge une jam po ai
 I zakonshmi
 Fytyres me pervijohet
 I ftohte shiu si shurra e nje te vdekuri
 Shiu te jep celesin e portes
 Te mbyll prane dritares a televizorit
 Me duart qe mbajne koken e enjtur
 Prej te ndenjurit
 Gjate me koke në duar
 «Ca pika shiu qane mbi qelq»
 Dhe une jam krejt vetem ketu në shtepi
 Duket casti me i volitur
 per te bere dashuri
 Por dashnoret i kemi larg me dashnore
 Asgje s'na falin ato
 Vec ca puthjesh
 Dhe kerkojne me ngulm te presim floket e gjata
 ... te hapesh dritaren e ta nxjerresh jashte
 Ekranin e televizorit

Gjithe bota te perlotet bardhe e zi
Nga filmat e mij humoristike qe deformohen zvargur
Prej ujit qe bie shi.

8 maj 1991.

TI DO VISH DHE POETIKA

Ti do vish në mengjes tek une
I mpire në shtrat kursej
Çarcafin, nuk ta rrudh carcafin e ri
Kam zene vetem një cep te shtratit tim
Si te mos dua te te prek
Ti do vish në mengjes neser
Do hysh pa fryme në carcafe
Aty ku ke qene gjithe naten, e druhesha
Mos te te cekja me gjunje
Nuk di pse po shkruaj
Jemi romantike, pra, merret vesh vete
Edhe pa mua
S'leme flutur nate pa kapur
E pa e ngjitur me boje në fletorke
(Nese kjo eshte poezia, une qenkam
Në fakt
Roje nate në konviktin e vajzave, të pres)

1992.

KJO LETRA JOTE E BUTE

Malli yne eshte i ndryshem moj vajze
 Në qytete te ndryshme
 Lodhem në ate nate te hershme, unike
 Ketu brenda ikonave guacka
 Te qepallave te tua
 Ku shkundin varak fluturat e nates
 Rri e lexoj i praruar
 Letren tende te vetme
 Ate frut te larget qe varet tani
 Duke u thare me dinjitet
 Në deget e kopshtit tim
 Letra jote
 Vjen pa deshire
 E terheqin zvarre fijet e flokeve te tu te asaj nate
 Qe si mina te harruara lufte
 Me plagosin vazhdimisht, nëpër rrobat e mijas fshehur
 Por une s'i di
 Letra jote e fundit, e lexoja qe ate agim
 Me ty në shtrat, qe flije ende
 Letren tende te vetme
 Ti struktur krejt mes kembesh te mijas
 Si nje ene me qumesht te vaket
 Une vereja aty poshte shtratit
 Sandalet e tua qe dicka dinin
 Vereja dhe e ndjeja
 Sapo t'i shkelje me thembra, une
 Do te mbetja pa fryme
 Duke pare
 Te ngriheshe
 Thua se do te ngjishje pas kembeve

Mushkerite e mijë te dyja, e do ikje me to
Pa zhurme
Nga ajo dhome që rastisi
Oh, në ta nissha letren tende lamtumire
Do te te trulloste edhe ty trishtimi

1992.

KERKOJ LAPSIN PER TE SHKRUAR

Me ke flas, kush degjon pertej

Rremoj, e gjej, e ndez si qiri lapsin
E prehem me një ngjethje pa fund:
Mish i gjalle në preherin e zhveshur
Me ulet një femije i vdekur

Per vjershen
E gjej lapsin, eshte një laps
Lapsi i varfër i syve te nenes, njomur
Me peshtymen e lotet e saj
Kam frike natën para pasqyres
I trukuar keshtu me vjersha

Po c'bej vallë, po me del duarsh vetja se
Pse kerkoi lapsin, ku je në sirtare
Si qiri, e kërkoi si qiriun që prapë na ndriçon
Edhe kur e dimë ku jemi, kur qartë shohim
Bile fare pa vargje
Aq qartë
Sa me vjen turp ta kërkoi me

Turpi eshte frika e fëmijëve
Qe (duan te) vrasin veten

22 shkurt 1993.

PARFUMI YT

Ti je? Ti je? E njëjta?

Goja jote varr i gjallë detar
Me aromën e fërnetit
Te puthitur trupat tanë nga frika
Në kërkim te mejhaneve pa garipa
Te portit
Por ama me “zhurmë e tym” i kërkonim
Qe askush te mos na shihte kaq pa frymë e te përkryer
E kështu s’ë gjenim nje te tillë, këmbët e rënduara
Si shishe na thyheshin në mes
Puthjet e rërën me brazda plagosnim
Në gjurmët tonë te thella varrosnim
Gjithë vitet qe kishim kaluar pa u njojur
Buzë detesh me emra te ndryshëm

Ajo natë në dritare si një pulë e zezë
Ngrohte te vëtmen hënë vezake
Nga ku del gjarpëri i gjithë mollëve

Mollët e tua te bardha
Bashkë i kafshuam
Dhe te nesërmen i mallkuam, kur
I njëjti autobus u nda me dysh
Per te na degdisur në te kundërt

Tani
Me nje guxim te mjerë
Nuhas gjithë ditën, te betohem
Gojët e shokëve në klub, per ate Zot
Eshte era e saj

3 mars 1993.

DIMRI

Vrapon një kalë prej qymyri, pa zë
E i tillë vjen a ikën dimri
Në rrugica
Kruhen pleqtë në gishta
Shesin cigare
Pulpa të kërcyera përtej dimrit
Rrjedhin e dalin prej meje
E pa e prishur rendin
Rendin
Vrapon kali, ato s'kanë ftohtë
Në çdo shtëpi një bibël, një sobë, një gjysëmgrua-fëmijë
Ulërijnë burrat, kokat pështjellë me letra
Dhe tërheqin botën për ta futur
Në kérthizën e tyre
Djemtë më të mirë na i hëngri futbolli
Këtë dimër pikërisht dua prej të tjerve
Po ato që kurkujt s'do t'ia jepja
I ftoj vajzat me një farë dhimbje, të më prekin
E qaj kur më ikin
Më ikin a më vijnë
Varrosur
Në kurrizin e zi të kalit prej ankandi

3 mars 1993.

KAFSHEZAT BASHKESHORTORE

I rrudhur krevati si fetus
 Ora me zhurma nuk e zgjon më një të papunë
 Kalon ora pesë e gjysëm në historitë familjare
 Ora gjashtë, shtatë, tetë
 E shoqja e tij ishte nëna e tij
 Para se të vinte shtrati
 Ka braktisur nëpër karrige oktapodë të balsamosur
 Që pa pikë misteresh gllabërojnë
 Gishtat e mij të mitur
 Po, po, dhoma e tyre është plot kafshëza të tilla të
 trallisura
 Lëshojnë aroma të molisura
 Që e bëjnë krimin të mendohet
 E aftë t'i shuajë në çast si hi
 (Era, aroma)
 Krahët e mij të zez prej engjelli

25 mars 1993.

KEMBET E MIJA

Shquaj në shtrat atë bardhësi që me dhemb
 (Mendoj se me rrjedh nga barku)
 Shquaj atë bardhësi mbi shtrat, e aty
 Gjunjët e mij shquaj e fyjetë e këmbëve
 Me atë këngë të rrallë qimesh
 Këtu nata kalon mbi mua e plotë
 Dhe e plotë shtohet në gjithë ëndërrat e mijë
 Nata tabu si gjarpëri i shtëpisë

Që s'duhet vrarë me gjithëse të kafshon, po helm s'ka
 E kështu vendosëm që të jetë shenjti i shtëpive
 S'e kam parë kurrë veten time, veç këmbë kam parë
 U flas për frikën
 Por unë s'kam hiç fantazi kur shpik veten
 Midis meje është kaq hapsirë e panjohur
 Ku kalben leopardët e gjumit
 Kaq hapsirë mes meje që desha netëve ta mbush me
 dikë
 Qesharake: me dikë çfarëdo që mundet
 T'ia bëjë edhe pa mua
 Falem përnatë në të njëjtën ikonë
 Dy copë këmbë të trishtuara në shtrojet
 Shpuar nga një gozhdë alkooli.

14 prill 1993.

EVA DHE ADEMI

Eva ishte një infermiere e vogël
 Nën përparëset që ia fergëllonte
 Një kurm biond
 Nën përparësen e bardhë
 Ajo e hutuar, ashtu e përkryer në shkurtësinë e saj
 Dhe sa herë i patën shpëtar shkallëve
 Shishkat e serumit
 Për Ademin, praktikantin e fakultetit të mjeksisë
 Ajo kurrë nuk pati ndjerë bezdi
 Përveçse kur kthente kokën e i vërente
 Çaknë ku mugullonte një lëkurë e rrallë pa qime
 Sështë fare nevoja këtu të themi
 Se si gjithë infermieret ajo

Një ditë më jepte përshtypje kuçke
 E në tjetrën prej ditëve jo
 Qëlloi aty, unë ende s'qeshë shtruar
 Në pavionin dy (kati i tretë)
 Një ushtar i plagosur, i zhytur në ethe
 Në bunker një natë, nga vëtmia a kush e di
 Qe mbyllur e shtinte brenda fishekë
 E ciflat e kishin përcëlluar, në gjunjë plumbi rikoshetë
 E gjysëm i shurdhët kllapuriste
 Në shtretër që i djersitte
 Sikleti i tij ishte torturues
 Tek zhvishej nudo në korridore, e shqiste fashot
 Me pulpat të rruara për turp të patientëve
 E të Evës, e gjora si një motër ia duronte
 Vllazërinë të marrit
 Pak a shumë kështu ndodhi
 Në turnin e vonë
 Kur Ademi, fshatar dhe konviktori
 Po e qetësonte ushtarë
 Që çapëlehej duke thirrur e kënduar
 E symbyllur qe edhe kur si përherë iknin dritat
 Errësi mbeti dhe zëri bubullinte në pavione
 Mbyste zhaurimën monotone të një radioje dore
 Ademi djalosh i thjeshtë
 As vetë s'e diti e u rrënqeth aty
 Mbi krye të kokërruajturit
 Kraharorin e ndjeu t'i valëvitej në terr
 Ndërsa një ish gjimnazist i gjakosur ushtar
 Këngëzonte Eseninin
 Ndaj kur hyri Eva (gjithë e tërhequr prej zhurme)
 Ai e tërhoqi per supi
 Dhe i kërkoi lotin t'i fshinte ajo
 Dhe ndodhi që në errësi

Ata i shmangën mantelet e bardha
 E u rrëzuan
 Plot erë jodi e ku e di
 Ashtu ngadalë u puthitën në shtratin përbri
 Nën atë fjalosje vetmitare plot kumb e varg
 Çarçafët të stampuar nga magazina
 Me ato iniciale të pakuptueshme
 Vulash trekëndëshe e rrumbullake
 Çarçafët i pikëloj një qumësht i errët
 Dhe kotej zëri i ushtarit me atë plumb në gjunjët e lagët
 Ai kurrë me një këmbë s'do ta ketë dhe drejtoria
 Si në libra Ademin e sikterisi
 E sikterisi edhe shkolla
 Në fshatin e tij në darkë, kur kthen nga miniera
 Nuhat tek e nxjerr mga sirtari
 Kanotjeren e asaj nate
 Me aromën e Saj gjithnjë e me pak shpuese
 E ashtu edhe më vrasëse
 Kopsitur me një njollë të verdheme
 Që i kujton këtij, syprishur, se duhet shpaguar
 Një gjak pa arsy
 Ne rrimë ulur tek ai shtrat i hekurt
 E kanë nderë në korridor si atë rrjetën e
 braktisur, magjepsur
 Që kapi peshkun ters (sirenën)
 Presim të heshtur e të sëmurë se mos njohim Evën.

29-30 prill 1993.

KRIJIMI

Çdo moment një mijëvjeçar i ri
 Përgatitej
 Për çdo pjesë të dheut që ende ...
 Dheu piqej symbyllur në kënaqësi të egra që dhembin
 Përditë dështonte krijimi në prova
 Mbusheshin pirgjet e zymta me turlifarë faunash të
 vdekura
 Dhe korre të vakëta krijonin në rrafsh
 Bimët e sintaksa
 E gjithë kjo ndodhë pa ndershmëri (njerëzore)
 Por jo në heshtje
 Ngrinin stërkala vullkanike masive përcëlluese kohësh
 E gjithë kjo ndodhë përditë atë javë
 Pa dëshmitarë, pa avokatë
 Trishtim kuadrat dhe rrëthor për mendimin
 Që përditë thahej në atë përmasë
 Në të cilën zinte vend diçka

1993.

TREDIMENSIONALE

Sa më tepër rroj, aq më tepër të harroj
 Peshqit edhe gjumin e bëjnë me kurriz nën hënë
 Që edhe dielli ua sheh ditën
 Edhe hëna në darkë kur flenë
 Barkun s'ua ledhaton me qimet e saj
 Domethënë ata kurrë nuk shtrihen në kokërr të shpinës
 Përndryshe të vdekur quhen peshqit

6♠

E unë si ata
Ose të kujtoj, ose jo
Ose të kujtoj, ose rroj
Nën të njëjtin kurriz të diellit e hënës

10 qershor 1993.

LA MANCHE

Në dhëmbët e mi si një premtim gjuha jote
E gatshme t'i zgjidhë pejzat e të shpëtojë
Pa drojë, me bezdi
Si një violinë gjuha, ku tela janë flokët e mij
E vockël, çfarë gjuhe flet llapa jote
Prej mize, si mizë ndalon e vdes e thyer
Në gojën time të ngordhur me erë
Hoje e papërfunduar pendese
Seks i inçestit final

12,13,14 qershor 1993 ?

EVOLUCIONI

S'ka pikë urtie në jehona
Shkoj e fshihem që në shpellën e dytë
Që në të tretën si ari e mbys në putra
Veten
Rri e lutem për pak mençuri
Për pak vetëpërmbytje rri e lutem netëve
Me një qiri të mishtë që lindet e rilindet

8 6

Por prapë çdo herë idiote janë çastet
 Që rroj pranë meje
 Ftohen krojet pa mua në shpella të tjera zhvoshken
 gardhet
 Treter ngjyra rozë në sy gjarpërinjsh
 Shkunden fise sarhoshësh në valle të ndershme
 Pa mua në shpella të tjera
 Më kanë mbyllur në rrëthin tim
 Nuk kam kohë të rritem
 Që të zë shokë të rinj në klasa të tjera
 Pres të vdes, të bëhem të paktën ç'kam qenë më parë
 Fillimisht është shpella e Mizave
 Pastaj kemi zogun e orën me zog
 Në rrëthin tjetër majmuni e profesionet
 Pastaj vij unë e fill pas meje
 Në shpella të tjera elefantët pa dhëmbë
 E specie të tjera që zhduken
 Dhe s'dihet ku shkojnë, në çfarë kthehen
 Gjithë këto rrathë ferri i kam byzlykë hajmalish
 Në kyçin e dorës sime
 Që dridhet kur është fjala për këto masturbime e
 vetëvrasje
 E fallsifikime të tjera firme
 I lutem Zotit të më bëjë të dhembshur
 Kur ta gjej veten

3 korrik 1993.

GJYSMA ME E MIRE E PUSHKATIMIT

Flutura të zbrazëta, të ujitura me gjemometri arabë
 Në gishta më kanë zbritur si unaza martesash
 Nga këto ditë, nga këto ditë s'po shpëtoj
 Gjithçka duhet është aty
 Garderoba e neveritjes
 Këpucë ecjeje të lustruara gjer në retinë
 Kravata
 Që të ofrohen
 Si për të mbyllur sytë para pushkatimit
 E unë i refuzoj, se pushkatimit i kam kthyer kurrizin
 Ashtu si gjithë gjérave që duhet të takohen me mua
 Për t'u bërë të plota
 Kështu që këto ditë s'më thonë gjë, por veç
 Të bëjnë të kujtosh
 Një kumt të vjetëruar nëpër kujtesa
 Që të vidhet ashtu i pluhurt në pellgjet e ballit
 E nuk të lë ta formulosh frazën e dëshirës së fundme
 Që të duhet edhe nesër ta gjesh
 Asgjë nuk më mësoi historia ime e njerëzimit
 Veç di se drejt hiçit të tërheq
 Një epsh pa objekt

16 korrik 1993.

VERESIJE

Proçesi solemn i humbjes së kontrollit
 Në pijetore të cekëta mëhallash, bakanale varaku
 Si një vajzë e vogël gota
 Më turpëron me drejtpërdrejtësinë e saj
 Të shpic në dhomën e saj e krejt e tendosur
 T'i tregon gjithë qëndizmat e saj jeshile e të kuqe
 Në prehërin e hapur parashkollor
 Adhuroj kombin stoik të grave të banakierëve
 (Këtyre u thërrasin “usta”)
 Komb kompakt që lan me bezdi urnat tona
 Dhe përgjon aty pas të shoqit
 Mbi përcartjet tona edipike
 Pas të shoqit që ne i thërrasim “usta” ose “mjeshtër”
 Thjesht pér arsyen se kështu ai paqtohet si qeni
 E nuk e tepron zullumin në alkimitë e lëngjeve
 Se ai nuk ka se si të jetë mjeshtër
 Lëngu s'ka mjeshtëri, vetë Zoti e zbriti

5 gusht 1993.

PUBLIKE DHE E TURPSHME

Seç mban banja e shkollës, një erë si plagë
 Ashtu e bardhë, si kokë e fashuar
 Sc zemra nuk fashohet
 Ja aty, me dhëmbë e mbante bluzën lart ngritur...
 Jam romantik: zhgarravis pak murin
 Dhe e mbyll ate derë grash si një plagë që s'mbylle

1993.

USHQIMET

Gjithë sigurinë që ma falin prindërit
 Ma heqin ushqimet
 Ju lutem ta vëzhgoni sillën time
 Kam ngrënë e pirë krishtin e natës së fundme
 Tek na ofrohej pa garanci, por thjesht në besim
 Në fakt i tradhëtar nga bakejtë e pastiqierët
 Piktore që llangosin me buzëkuq vezët
 Tashmë nuk e di se ç'po ha
 Po pra, hamë grurët, qengjat, kërmijtë
 Në barqet tanë të fshehur prej guri buçasin flakët e flive
 Flijimeve për një perëndi të paguar nga unë
 Që më komandon vullnetin
 Trupi im është një prostitutë më vete
 Si në një dorezë lëkure
 Futet dora e ngrënëshme e djallit në barkun tim
 Ai po na përdor pastër
 Me vanilje dhe uthull po e gatuan zemrën tonë
 Mësyjnë zahiretë, nëpër bute komploton turshia
 Dhe orizi
 Tabutë kullojnë lyrë nëpër shkurre me gjahtar nga pas
 Ngjethen ushqimet në morgjet shtëpiake prej frigoriferi
 Dhe na sulmojnë si kobra me dhëmbë akulli
 Nuk e di se ç'po ha kështu që s'di ç'kam në bark
 Kështu që s'di kush jam e ç'flas
 Nuk di ku do të shkoj
 Unë jam afati i skadencës

1994.

JETIMORJA

Regëtin ecja e kërmillit në mes të jetimores
 Pllakat bardhë e zi, bardhë e zi kuadrat i ndajnë ditët
 Ku mllefi i kuzhineres pushkaton makarona
 E therrën dhe rojën, pulën e vetme që mbeti
 Tingujt e fundit të tij përshkuan
 Përmes njëherësh
 Gjithë fijet e barit, flakëza jeshile qiriu
 Homazh në kopshtien ilustrimin braktisur në botime
 abetaresh
 Të një etnie të përndjekur që fiket
 Homazh përrugën e qumështit të kërmillit
 Mu përmes bardhë e zi, bardhë e zi
 Tek e heq me llapë shijen e pasdites
 Që i ul brekët e vakëta pasditja
 Mbi tullat pa nëna
 Të avllisë që rrëthoi ndërtesën:
 Tre çunat aty u rritën: pa lëvizur shijojnë dashurinë
 Puthitur nën kutitë e këpucëve
 Pa nënë, pa nënë
 Pa gjiret e vegjël te bluzës me vija
 Që as sot s'shkoi në shkollë
 Jo, jo, nuk qe rojtari pula që therrën
 Për të premte zakonisht kopilat
 Hanë pastorin danez në kat të dytë (tre kate ndërtesa):
 Ky i mbolli gjithë biblat në saksitë e dritares
 Për të sajuar i humbur, atdheun te largët.

1993.

BEJTE PER TRIBUNE TONE NE TE HYRE TE NATES (Fragment)

“Pesëmbëdhjetë vjeç kur i mbusha
Rash n’kontakt me ca zonjusha...”

“- S’di unë rok, këngë partizanc
Deklaron shoferi Mane

Di veç këngë rruge të rrugës me goca që ndizen si zjarri
me shqiptarë pisqollëmëdhenj që s’shkulen nga istikami

E ju djem që jeni sot s’u ka hije hiç kitara
se bandillë të bukur kishin veç të ritë e mi të para”

E ne shume të mardhur jemi, shishes i vijmë me pranë
Tomka sy prej manaferre prapë na e këputi la-në

E shyqyr s’e pa Dafi, ky në tavolinë po fle
Mjekrrën e qullur me vodkë, kaçurreli nëpër dhe

Se kitarën ky do fort, e ka prurë që përtej deti
Dru i pastër i bekuar blerë me pare kurbeti

Ja dhe Oli ku po flika, në karrige gjéré e gjatë
Barku i tij i bardhë i madh, hënë e plotë është nëpër natë

Gotat shtimë unë me Lailën, një për Ceken, një për veten
Vëllait që na mungon, prapë se prapë ia bëjmë adetet

se dashuritë pa rakinë se si veniten e treten

Në rakinë formalinë, zemrat pa u prishur mbeten
 Bebi vjen me flokë në erë, plas përtokë bijkletën
 - Cigaren që kam o çun, ta djegim përgjysëm të
 shkretën

- Shishe, i lutem shishes tjetër, të lutem ti vdis ngadalë
 Mëshirë ki për borxhet tonë, dhe rininë tonë të parë

Të lutem natën ta zgjasësh e jetën të ma shkurtosh
 E me lëng të më mbushësh zgavrat e syve bosh

Po shokët thonë të mbyll gojën se nuk po durohem fare
 Vjershat mos t'i hedh ne erë, po t'i shkruaj të nxjerr
 pare

Meqë s'po më mbahet goja, e sigurtë që jam bërë tapë
 Hurbat e fundit që ktheva, me zbritën të gjitha në jakë

Gjithsesi sot faqe femrash gojën s'e prisha edhe aq
 Ky Xhudasi, skatologu, më gjykon gojëfarmaq...

1993.

24 KARAT (Fragment)

Ora elektronike
 Dhe 24 stadiume bosh
 Po ikën dita
 Shkallaret me dasmat e mëdha të tifozëve
 Ai oriz mashkullor biletash të grisura, cigaresh
 Në dasmat e braktisura me jevgj ambulantë pa klarineta

E pederastë të dekluar që shanin nënash si pulëbardha
Poshtë, me gëlqeren
Bari i dënuar me vdekje sportive

1993.

TIRANA
(fragment)

Ky qytet i poshtër, ah, më hëngre
Me të pabesë

T'i hapa letrat, me 'to shpirtin

Poetë, ju kuaj troje

Të rralla sa udhëtimet
I kam kockat
Që s'do m'i tretë dot
Vendlindja

1993.

NATA X

Bie nata pa u rënë në sy
As femrave
Bie nata, rrjedh gjoja papritur
Siç para pasqyrës i shkasin lidhëset
Vajzës së lodhur
Bie nata, kjo ndodh kaq lirshëm

Tragjikisht kaq shpesh
 Nisin t  vетojn  n  faqet e mij 
 K to pu rrat e qillit
 K naq si e detyrueshme, martesore
 Bie, pra bie pashmangsh m
 Si nj  or  me r r  e kthyer p rmbys
 M  mbulon hiri i vak t i k mb ve t  mij  prej cigareje
 Dhe ia arrij q llimit t  jem
 Mask  e dehur nga vetmia
 E  jan  ato t  tjerat (dob sia...)

Bie nata pa u r n  n  sy...

25 shkurt 1992.

KENGET E VETEVRAJES

Nuk jan  tallje k to
 Tatuazh jan 
 N  mes duhet t  eci, si Uliksi
 Pa u joshur nga era e gjakut
 Q  mugullon brenda virg ris 
 s  thikave
 Nuk m  lodh ngasja, ngase e kam frik 
 Q  t  mos e harroj, e piktuoj gjith  dit n
  do dark  nga xhepi e nxjerr
 Shamin  e q ndisur
 Dhe si nj  gjoks t  bukur e zhvesh
 E zbuloj at  medalion
 Vdekjen time personale

Që është një kopje origjinale
Hajmali e rreme pra
Por edhe e tillë m'i përvëlon shputat

1992.

PA NDONJEFARE TITULLI TE RENDESHISHEM

këto netë mbi pjesë qytetesh
këto zjarre të pandezur mirë
qyteti, tashmë, matet vec me të pirë
këta duke mërmërirë
maten me qytetin (drita brenda mureve)
kjo guerilje tashmë është gati, por s'e di
shohin vëngërr, marrin porosi
unë qetësohem, them "mirëmbërma"
larg qyteti vërtiten fushat
qentë ndryjnë brenda vetes
sixhade të shqipërisë etnike
qen të braktisur rruge
që i vret policia me plumb
si fëmijët e paligjshëm në brazil
qentë brenda kanë
qentë brenda kanë miq e vatra
tek angullijnë
me pak evolucion në frysëmarjet vetëmbrojtëse
me pak të drejtë, me pak arsim ndoshta
ndoshta qentë po lehin, angullijnë
midis semaforësh realizojmë qytetin
të dashurat e njerëzve shtrirë, horizontalisht
kazanet e plehrave të punuar përbrenda

kazanet e plehrave plot evolucion
 në qytete punojnë edhe radiot
 kur ne flejmë, dikush rri pranë radios
 do të doja t'i grumbulloja të gjithë të mbijetuarit
 dhe t'ua fikja radiot me një gjest të butë e kuptimplotë
 vetëm tërmeti kur bie na vëllazëron
 çdo mesazh tjetër për miqësi
 për mirëkuptim
 dështoi në homoseksualizëm
 qyteti pret ditën kur asnjë
 nuk do të kujtohet/kujdeset
 për të ndezur apo fikur dritat
 të lidhë/zgjidhë këpucët
 qyteti na pret solemnë
 pret ditën kur paraja fallco
 do qarkulloje krenare bri
 parasë tamam
 pret ditën kur nënë e bir nuk do të ndahen më
 në prag të maternitetit
 po kërthizë për kërthizë
 të mos shqiten kurrë
 gjer në vdekje
 ky qytet nuk ka nevojë
 që këngët të kenë fjalë e njerëzit gojë
 kërkon të na i falë/ngjallë
 shkronjat në tabela
 me emra sheshesh, rrugësh
 që janë emra prindërish tanë a kushërinjsh të vdekur
 apo emra me numër datash të caktuara fitoresh
 datëlindje
 që përkuan tek përkojnë
 me orët tonë
 unë nuk besoj të jem duke folur
 për kthimin e mesisë

dëshmova për pushimin e afërit të gjakderdhjes
 dhe për shqisën harmonike
 asgjë më tepër
 dëshmoj për fundin e gjakut
 motra, mos u trembni
 emëroheni
 të virgjëra gjer në vdekje
 fëmijët mos i pritni nëpër javë
 qyteti nuk pret më vizita
 e ju mos pritni vizione të reja
 këto orë janë dritaret e fundit të qytetit
 nuk e di nga i di gjithë këto gjëra natën
 po prapë dëshmoj se e ndjej
 fundin harmonik; e kanë ndjerë edhe baballarët
 të papërgjegjshëm
 fill pasi lageshin nëpër mishin e dyshimtë që më polli
 e ndaluar

mars

*6^{er}
zrapush*